


Thanas Medi, fitues i çmimit për veprën më të mirë letrare për vitin 2013, rrëfen për jetën në emigracion, fillimet e tij si shkrimtar, përvojën e fituar nga botimi i katër romaneve si edhe synimin për t'i përkthyer në gjuhët e tjera.

THANAS MEDI

Kur botova romanin e parë kisha ndrojtje t'ua tregoja të tjerëve

Kur isha një emigrant i zakonshëm në Athinë dhe kisha me atdheun vetëm një lidhje konkrete, atë të botimit të librave atje, më thanë në telefon: "Nisu për Tiranë se ke fituar çmimin e Ministrisë!" Sigurisht që e quaj fat, pak fat duhet gjithmonë. Me çmimin, sikur dola mbi sipërfaqe, nxora pak kokën mbi turmën e pafund me shkrimtarë. Sikur m'u hap një rrugë e nisur shumë vjet më parë, m'u dha një shans të tregoja kush isha.

(fq. 2)



Portreti nga Ina Lajthia

SHËNIME MBI POEZINË E BASRI ÇAPRIQIT

nga Sadik Bejko

(fq. 6)



Leximi në epokën e shpërqendrimit të pareshtur

nga Mairead Small Staid
(The Paris Review)

"Lexoj libra për të lexuar veten", shkroi Sven Birkerts në "Elegji për Gutenbergun: fati i leximit në një epokë elektronike". Libri i tij, i cili sivjet mbush njëzet e pesë vjet që është botuar, përbëhet nga pesëmbëdhjetë ese për leximin, veten, pikëtakimin e tyre, dhe mënyrat se si të dyja kërcënohen nga depërtimi i teknologjisë moderne.

(fq. 14)

NJË HESHTJE PËR VDEKJE

ese

nga Rexhep Ferri



TRANSISTORI

tregim nga

Adil Olluri

THURIMA POETIKE SI PËRKRYERJE NË VIJIMËSI

(Variant leximi i poezisë

"Kristal" të I. Kadaresë)

nga Tomorr Plangarica

Do ta orientojmë interpretimin tonë të poezisë "Kristal" duke pasur parasysh tre faktorë që mundësojnë interpretimin e këtij teksti poetik: a. Prirjen e natyrshme të lexuesit për t'iu përafëruar paraqitjeve mendore të folësit në tekst; b. përfitimën e kuptimeve të reja, si pasojë e konceptimeve të rimodeluara nga nxitja e asosacioneve të pranishme në thurimën poetike; c. lidhjen e veçantë që përftohet në skenën thënësore me realen/referentin, jo si lidhje përshkruese, por evokuese, abstraktuese, jo për të gjetur një referent të drejtpërdrejtë, por më shumë një rrjet të hapur asosacionesh.

(fq. 10)

PËR "LASGUSHIN E PANJOHUR" TË MOIKOM ZEQQOS

nga Llazar Llazari

(fq. 5)

ZËRAT E HISTORISË NË DRAMËN E VETME TË KONGRESIT TË LUSHNJËS

VISAR ZHITI:
Në ndjekje të porosisë

si e pa përfunduar, e mbetur në dorëshkrim që nga mesi i shekullit të kaluar, - kisha thënë, - por me gjakimin, që, nëse do t'ia kërkonin ndonjëherë të vihej në skenë.


(fq. 12)

VEZA E ZEUSIT

tregim nga

Panos Ioannides

(fq. 9)



Thanas Medi, fitues i çmimit për veprën më të mirë letrare për vitin 2013, rrëfen për jetën në emigracion, fillimet e tij si shkrimtar, përvojën e fituar nga botimi i katër romaneve si edhe synimin për t'i përkthyer në gjuhët e tjera.

THANAS MEDI

Kur botova romanin e parë kisha ndrojtje t'ua tregoja të tjerëve

Intervistoi: Bujar Hudhri

“Shkrimtari është i tillë që nga fillimi i jetës, veçse i duhet kohë ta kuptojë”, - thotë një kolegu juaj i shquar. Lexuesi e ka kuptuar shumë vonë që ju jeni shkrimtar. Po ju vetë, kur e keni ndier veten të tillë?

Lexuesi e kuptoi kur lexoi librin dhe e pëlqeu atë, kurse unë duhet të kem qenë pa e kuptuar se jam. Kur them “unë”, kam parasysh gjithë ata që e meritojnë të quhen shkrimtarë, që kanë një fillesë të përbashkët për atë se kur nisën të dallohen si të tillë, në ç'moshë e shfletuan librin e parë. Tani që vështroj pas në vite, u përkisja atyre njerëzve që, kur nuk më tërhiqnin librat e shkollës, më përthithnin ata me përralla, legjenda e më vonë me poezi, tregime, novela e romane. Që s'vajta në shkollë, se më duhej të mbaroja së lexuari një roman. Që lodra më e bukur e fëmijërisë ishte libri dhe nëse më binte në dorë një lek, nuk e prishja për të marrë diçka për të ngrënë, por për të blerë libra. Është një përkitje që ndodh si pa kuptuar, se ashtu të pëlqen të ndodhë. Që të mban mbërthyer për të bërë ca gjëra që nuk mund t'i bëjnë të gjithë. Që të jep një stimul të veçantë, një besim të tepruar në vetvete, sa shpesh të të duket vetja mbi të tjerët. Ta shikosh veten sikur ke në dorë diçka magjike dhe të tjerët s'e kanë. Si në përmbyllje të pyetjes suaj, shtoj edhe këtë: edhe nëse mund të kem qenë shkrimtar që në krye të jetës, akoma edhe sot nuk ma nxë goja, ndruhem të them: “Jam shkrimtar.” Nuk e di nga se vjen kjo, ndoshta nga adhurimi gati qiellor që kam pasur për zotërinjtë e penës, si ata që merren me ca punë tepër të fisme e s'arrihen lehtë. Apo se e quaj një profesion që, në mënyrë të përkryer, s'mund ta zotërosh kurrë plotësisht.

Duhet ta pranoni se jeni me fat: emri juaj u bë i njohur më parë si fitues i çmimit më të rëndësishëm letrar të vitit 2013, dhënë nga

Ministria e Kulturës, si autor i dy romaneve. Ç'ndikim pati kjo në jetën tuaj si krijues?

Është fakt, sot shkruajnë shumë, çdo ditë botohet një libër, çdo javë lind një shkrimtar. Është një mani, shpeshherë në kufijtë e marrëzisë, nga e cila më së shumti përfitojnë botuesit e papërgjegjshëm. Ata që e shohin librin vetëm si mall dhe jo si ushqim shpirtëror për një shoqëri të tërë. Krijohet kështu “populli shkrimtar”, ku të gjithë shkruajnë dhe askush nuk lexon. Hapet, nga ana tjetër, një hendek, ku ti si krijues, edhe nëse e meriton titullin shkrimtar, të bie në kokë mallkimi i përgjithshëm, përjeton zhvleftësimin që i është bërë këtij profesioni të lartë. Shprehur më


së shumti me: “Sot të gjithë u bënë shkrimtarë!” Të vret ajo pyetja ironike: “Edhe ti shkrimtar?!” E kam provuar në kurriz këtë, me romanin e parë sidomos. E fshihja librin kur gjendesha mes njerëzish të thjeshtë, si të kisha bërë ndonjë krim. E kisha për turp që isha shkrimtar. Po kështu edhe me romanin e dytë, veçse turpërimi nuk zgjati shumë. Dhe kjo falë çmimit që përmendët ju. Kur isha një emigrant i zakonshëm në Athinë dhe kisha me atdheun vetëm një lidhje konkrete, atë të botimit të librave atje, më thanë në telefon: “Nisu për Tiranë se ke fituar çmimin e Ministrisë!” Sigurisht që e quaj fat, pak fat duhet gjithmonë. Me çmimin, sikur dola mbi sipërfaqe, nxora pak kokën mbi turmën e pafund me shkrimtarë. Sikur m'u hap një rrugë e nisur shumë vjet më parë, m'u dha një shans të tregoja kush isha. Nga ana tjetër, më rriti përgjegjësinë për të shkruar gjithmonë mirë, për të mos u dhënë të drejtë gojëve të liga të hidhnin baltë, ta quanin çmimin rastësi. Çmimi, më tha një njeriu im, u mbylli gojën shumë njerëzve, por po kaq të tjerë presin shumë nga ti.

A mund të na e shuani kureshtjen: ju i përkisni komunitetit vllah, ndërkohë shkollimi dhe edukimi juaj është bërë në gjuhën shqipe, tani jetoni prej tri dekadash në Greqi. Në procesin tuaj krijues çfarë dominon më tepër?

Unë linda vllah, u rrita e u formova shqiptar dhe “shtyj” jetën tani si grek. Me këtë dua të them se njeriu është më së shumti ai që lind dhe ai që formohet si njeri. Dhe ky formim nuk zgjat gjithë jetën, ka një cikël përmbyllës, që si tavan mund të quajmë moshën tridhjetë-dyzetvjeçare. Formimi im është kështu i dyfishtë, midis të qenit vllah dhe të qenit shqiptar, ku të qenët vllah është disi abstrakt, mbijetojnë ca fije më së tepërmi shpirtërore, një si “amanet i të parëve”, ndërsa të qenët shqiptar është konkret. Fiton pak nga pak mbi të parin, shqiptarizohem si pa kuptuar, flas më së shumti shqip, mendoj vetëm shqip, dëgjoj, lexoj dhe shkruaj vetëm shqip; e kjo detyrimisht do të dominojë edhe në krijimtarinë time. T'ju them diçka: kur botova romanin e parë, *Hija e mallkuar*, për emigracionin, njerëz të rrethit tim më thanë: “Ti këtu je më shqiptar se shqiptarët.” Pati edhe ndonjë që e flaku librin nga dritarja se, sipas tij, shaja grekët dhe mbroja shqiptarët. Kurse tani që kam fituar njëfarë emri, është ngjallur xhelozia vllahe, ka shumë që më hedhin gurë pse shkruaj vetëm në shqip dhe nuk shkruaj në vllahçe apo arumanisht – në gjuhën e nënës, me një fjalë. Vështirë se më kuptojnë kur mbrohem duke thënë se, mirë a keq, unë jam shqiptarizuar. Ndonëse me gjak jam vllah, në ndërgjegje, formim, jam shqiptar. Dhe kjo është e pamundur të përmbysset. Ndërgjegjja fiton mbi gjakun, kur ky nuk gëlon në shtratin e natyrshëm të tij. Ndihet më mirë në një shtrat tjetër. Kur gjuha e lindjes e ka të vështirë, të pamundur, të shprehë kulturën që ti mbart. Dhe e bën më mirë këtë një gjuhë tjetër, për rastin tim, gjuha shqipe.

Në romanet tuaja të para lexuesi nuk e ka të vështirë të shohë pas personazhit kryesor vetë autorin. Me kohë ky ngjasim nuk bie edhe aq në sy. A mendoni edhe ju kështu?

Jo vetëm mendoj, por e kam shprehur këtë. Tri romanet e mia të para i kam quajtur edhe si njëfarë trilogjie autobiografike, meqë “jam”



edhe vetë mjaft i pranishëm brenda tyre. Është një prani letrare, sigurisht, ku elementi biografik i nënshtrohet magjes së magjisë së krijimit, se ndryshe ngjarjet do të jenë interesante vetëm për një rreth të kufizuar njerëzish dhe s'do të gjenin rezonancën e përgjithshme, atë që e bën një libër pjesë të të gjithë njerëzve, pavarësisht cilit komb e ç'gjuhe i përkasin ata. Kur nisa të shkruaj, "i vura detyrë" vetes që t'i dëftoja lexuesit diçka shumë timen, diçka nga unë. Nga vuajtjet, gëzimet, hidhërimet, fitoret a dështimet e mia. E pashë të udhës të zbuloj botën time, pa dashur të di nëse do t'i shkonte ajo për shtat botës së përgjithshme. Preferova të kem zërin tim, edhe nëse ky mund t'i vriste veshin ndokujt. Pasoj më pas romani i katërt, i sapobotuar, *Valsi i një dasme fantazmë*, që është si një dalje nga bota ime e vogël për të shkelur në botën e madhe, por pa e tradhtuar, pa i ikur dot plotësisht asaj. Ishte një ikje që unë as e dëshiroja, si të mos bëja dot pa të. Di të them këtë: botës së madhe unë i qasem me botën time të vogël, në arenë nuk dal të luftoj me armë të vjedhura apo të huazuara, të të tjerëve; luftoj (shkruaj, me një fjalë) me armët e mia.

Jeni rritur në një kohë kur në Shqipërinë e para '90-s lexohej shumë. A mund të na listoni librat që ju kanë formuar dhe ju kanë mbajtur gjallë pasionin për t'u bërë shkrimtar?

E dëgjoj shpesh këtë pyetje t'u bëhet shkrimtarëve dhe gjithmonë përjetoj një rezervë. Mendoj se më e drejtë është të pyetet për autorin që ka ndikuar në formimin tënd dhe jo për disa libra të caktuar. Pasi autori nuk është një libër i vetëm, është gjithë vepra e tij, duke shënuar ndikimin më të lartë ajo më e arrira. Dhe, meqë erdhëm tek autorët, më duhet të them se ata zënë fill që nga Homeri, për të vazhduar me majat e letërsisë së mëvonshme, të përbotshme: Shekspiri, Servantesi, Dikensi, Balzaku, Tolstoi, Drajzeri, Floberi, Çehovi, Shollohovi, Gëte, Markezi etj. Fakt është se edhe ata që nuk janë maja, diçka kanë lënë në formimin tim, diku më shumë e diku më pak. Ashtu siç kanë lënë edhe më të mëdhenjtë e letërsisë shqiptare: Migjeni, Kadareja, Agolli, Kuteli, Jakov Xoxa, Koço Kosta etj. Gjithsesi, mund të bëj një veçim për atë që thamë, ndikimin, shkrimtarin që e kam pasur më për zemër; këtu më vjen ndër mend Balzaku, betimin që i bëra vetes kur isha gjimnazist se do të bëhesha si ai. Markezin pastaj, që më dërmoi me *Njëqind vjet vetmi*. Apo Kadarenë, me veprat më tronditëse të



tij. Dua gjithashtu të përmend edhe ata libra që më kanë ngelur të paharruar dhe kanë shënuar fëmijërinë time: *Shpella e piratëve*, *Tregime të moçme shqiptare*, *Djemtë e rrugës Pal*, *Bija e Montezumës...*

Shkrimtari i njohur Ardan Kyçku, në një intervistë për gazetën tonë, thotë se pa mërgimin një shkrimtar nuk mund të jetë i plotë. Ju keni një periudhë gati tridhjetëvjeçare në Greqi. Si mund ta shpjegoni me përvojën tuaj?

Mendoj se kjo nuk qëndron, plotësia (po ta quajmë kështu) e një shkrimtari nuk varet nga ajo se ka mërguar apo s'ka mërguar. Po të pranojmë këtë, duhet të pranojmë tjetrën, se ata që s'kanë mërguar janë shkrimtarë të cunguar, gjë që vështirë ta besoj. Meqë kam një përvojë të gjatë në mërgim, mund të them se "ksenitaja" (e huaja) më tepër më ka penguar sesa favorizuar. E mira

e mërgimit është se të njeh me diçka të re, me një botë e mendësi tjetër, por është njëkohësisht vuajtje për një emigrant. Për më tepër për një krijues, që do të shkruajë dhe rrethanat e pengojnë për të shkruar. Proza e gjatë, sidomos, kërkon ca rrethana të tjera, më komode, e jo punën fizike, siç e kam ushtruar unë për vite të tëra. Do t'i jepja të drejtë Kyçkut, në qoftë se do ta gjeja të shtruar në mërgim dhe s'do bija nga shiu në breshër. Gjithçka ka të bëjë me përvojën personale, ndaj s'mund të nxirret përfundim i njëjtë për të gjithë.

Për shkrimtarin është shumë i rëndësishëm lexuesi i tij. Por ju në mërgim, fatkeqësisht, nuk e keni. Do të doja të dija, si e përjetoni këtë mungesë? Si ia bëni, p.sh., që të huajt atje të marrin vesh se jeni shkrimtar? A ju trishton kjo gjë, ndryshe nga këngëtarët, muzikantët, piktorët apo futbollistët që nuk e kanë këtë vështirësi?





Virion Graçi, Thanas Medi dhe Agron Tufa, në stendën Onufri, Panairi i Librit Tirana 2019

Ata që thonë “shkruaj për qejfin tim”, gënjejnë. Në të vërtetë, të gjithë shkruajnë që të lexohen nga dikush. Të pëlqehen e të kenë sa më shumë lexues. Gënjeshtrë është edhe ajo tjetra, siç mendojnë disa, se sa më pak lexues të ketë një shkrimtar, aq më i mirë është ai. Nëse është e vërtetë kjo, ç’duhet të themi për Markezin që, kur botoi *Njëqind vjet vetmi*, njerëzit e përpinë librin në të gjithë botën. Vështirësia e kontaktit me lexuesin qëndron se është mërgimi në mes, por meqë librat i botojmë në Shqipëri, e keqja zvogëlohet, është sikur jemi edhe ne aty. Nga ana tjetër, për sa kohë shkruajmë në shqip, mbetemi të panjohur për të huajin, anonim. Thjesht njerëz që dinë vetëm të punojnë, që s’kanë mendje, kanë krahë. Dhe kjo pa dyshim që na vret, për më tepër kur të merr në punë një fshatar grek që vetëlëvdohet se çfarë bën në arë. Ndryshe është kur has në njerëz të arsimuar, atëherë të bëhet e papërballueshme dëshira të tregosh se cili je, ç’mund të bësh. Është befasim i bukur për ta të thuash lexoj libra, jam shkrimtar.


Ç’vend zë në krijimtarinë tuaj romani më i fundit, *Valsi i një dasme fantazmë*? Nga u nise, ç’të ngacmoi për ta shkruar atë?

Valsi i një dasme fantazmë nuk është thjesht libri i radhës, një roman më shumë. Është shlyerje e njëfarë detyrimi ndaj asaj që jetuam në diktaturë, përgjigje e një sërë pyetjeve që na mundojnë vazhdimisht, për atë se pse heshtëm atëherë. Pse iu nënshtroam plotësisht mekanizmit të frikës, kush është përgjegjës për mjerimin tonë, ç’duhet të mësojmë nga historia që ajo të mos përsëritet. Është një dëshmi për moshumbjen e kujtesës, mosharresën, në një kohë kur njerëzit harrojnë lehtë. Është një qasje që i bëhet brezit që nuk e jetoj diktaturën, për të mësuar të vërteta të hidhura në lidhje me atë. Zbulohet shëmtimi i saj, ajo që u mbulua me histeri komuniste, me të qeshurën false, duartrokkitjet frenetike, degradimi i njeriut në

robot, në “i ri”. Sjell një kohë ku e bukura u vra, u varros, u mbyt. Është njëherazi një vepër artistike që ka për gjetje, strumbullar rreth të cilit do të vërtiten ngjarjet e mëvonshme, një pyetje të vetme, dëgjuar rastësisht. Rastësia i hap rrugën kështu domosdoshmërisë për krijimin e një bote artistike që vështrohet në pasqyrën e botës së vërtetë.

Tani që keni botuar katër romane në shqip, a keni menduar për përkthimin e tyre në gjuhë të huaj?

Kam menduar edhe pa qenë katër romane, që kur ishin vetëm dy. E nisa këtë përpjekje me *Fjala e fundit e Sokrat Bubës*, hoqa në kurriz vështirësitë e



gjetjes së përkthyesit të aftë, u zhgënjeva në shumë raste, derisa gjeta atë që duhej, poetin e njohur minoritar Andrea Zarballa. Pas përkthimit u vura në kërkim të botuesit, vuajta jo pak me këta, paguaja haraçin e të qenit shqiptar, i panjohur njëkohësisht, por, më në fund, u gjend edhe ai që mori përsipër botimin: Z. Petro Papasarandopoulos, i shtëpisë botuese *Epigentro*. Prej dy muajsh *Fjala e fundit e Sokrat Bubës* qarkullon tani në greqisht, me titull tjetër, *Nomadët e fundit*. Një botim tjetër kam bërë në Rumani, nëpërmjet përkthyeses së talentuar, poetes e mikes së madhe të shqiptarëve, Oana Anca Mihaela Glasu. Së shpejti, *Fjala e fundit e Sokrat Bubës* del edhe në rumanisht, nga shtëpia botuese *Eikon*, me qendër në Bukuresht.

Duke ju ndjekur në rrjetet sociale, shoh se jeni një komunitet shkrimtarësh dhe poetësh në Greqi. Por a është kjo e mjaftueshme? A keni kontakt me botues e krijues grekë? A lexoni libra në greqisht dhe si ndikon kjo në letërsinë tuaj?

Athina, besoj, është e para për sa i përket numrit më të madh të shqiptarëve të mërguar vitet e fundit dhe mes tyre, pa dyshim, s’do të mungonin shkrimtarë, poetë, aktorë apo muzikantë të njohur. Siç është e natyrshme, u krijuan shoqata e tubime të ndryshme e këtu edhe shkrimtarët do të kërkonin njëri-tjetrin. Letërsia me të vërtetë bëhet vetëm, por e nevojshme është edhe kontakti, njohja, promovimi i krijimtarisë së secilit. U krijua kështu vatra e parë e shkrimtarëve, klubi “Drita”, drejtuar nga poeti Nase Jani, i cili mblodhi rreth vetes të gjithë ata që ishin të apasionuar pas të shkruarit të librave, pa ndonjë kriter cilësor. Më vonë, nga ky grupim, me pretendimin e inkurajimit të letërsisë cilësore dhe jo të kujtdo që mund të botonte një libër, u krijua lidhja e shkrimtarëve “Liter-Art”, me drejtues shkrimtarin dhe kritikun e njohur të artit skenik, Miho Gjini. Sot ka edhe grupime të tjera krijuesish më të rinj, ka krijimtari cilësore, por që mundësitë e njohjes, botimit, janë të pakta. Në këtë aspekt, dolën edhe gazetatat e para shqiptare, *Gazeta e Athinës*, *Tribuna*, *Albania Press*, por pa mundur t’i rezistonin rrjedhës së kohës. Së fundi, edhe televizioni *Tribuna* i shkrimtarit dhe gazetarit të njohur Robert Goro. Ndërsa për sa i përket kontaktit me krijues dhe për më tepër, botues grekë, gjendja është vërtet për të ardhur keq. Libra në greqisht lexoj, por vështirë se ata ndikojnë në letërsinë time, duke përjashtuar korifeun e prozës greke, Kazanraqin.

Këtë muaj, Ministria e Diasporës ka ftuar shumë shkrimtarë shqiptarë që janë në emigracion, mes të cilëve edhe ju. Me sa di, është hera e parë që ndodh një ngjarje e tillë. Ç’do të dëshironit, realisht, nga vendi juaj dhe lexuesi i këtushëm?

Është një gjest për t’u lavdëruar ky i takimit të shkrimtarëve nga Diaspora dhe jo vetëm. Një “dorë e ngrohtë” e atdheut, si të thuash, për ata që kanë ftohtë në vise të huaja. Një mundësi njohjeje e shkëmbim përvojash. Kurse nga lexuesit duam atë që duan të gjithë, si brenda, si jashtë Shqipërisë: të na lexojnë. Se ka një mani të verbër lexuesi shqiptar: do vetëm, a më shumë, shkrimtarin e huaj. Kujton se ç’jven nga jashtë është e mirë dhe ç’del nga brenda është e keqe.

PËR “LASGUSHIN E PANJOHUR” TË MOIKOM ZEQQOS

Nga Llazar Llazari

Kur lexon librin e Moikom Zeqos, “Lasgushi i panjohur” dhe kupton se sa pak e ke njohur Lasgushin. Aty shikon Lasgushin e gjithëanshëm, me interesa të gjera studimi, me njohuri të thella gjuhësore, artistike, letrare e historike tej kufijve shtetërorë. Shikon poliglotin, njohësin e thellë të mjaft gjuhëve. Krijuesin e rafinuar dhe përkthyesin e kolosve të letërsisë botërore. Pikturin jo pa të ardhme, që la pikturën për poezinë. Poetin delikat e të papërsëritshëm lirik. Atdhetarin e flaktë, me dashuri për tokën arbërore e bukuritë e saj, për historinë e gjuhën e lashtë, për mundësitë e mëdha si një vend që i përket Evropës e kulturës së saj.

Nuk gabon Moikomi dhe kur veçon Kosovën, në atë kohë dashuri e brengë e madhe e Lasgushit, apo gëzimin e tij kur u ftua ta vizitonte në fillim të viteve 80-të të shekullit të kaluar dhe që s’u realizua. Ai s’i ndante trojet arbërore me kufijtë shtetërorë dhe të habiste me gjetjet e tij poetike. Mjafton të kujtosh vargjet e herëshme: ...\\ Duke nisur udhëtimin mes-për-mes në Shqipëri,\\ Drini plak e i përrallshmë, që mburon prej Shëndaumi...\\

Edhe miqësia me Lasgushin, ndonëse me jo pak diferencë moshe, flet për mendimin pozitiv e vlerësimin si pakëkush të Moikomit të ri, për këtë figurë të ndritur të letërsisë shqipe, kur të tjerë i qëndronin larg. Kjo dëshmon dhe kujdesin e objektivitetin e lirikut të madh në zgjedhjen e miqve. Ai nuk shikonte moshën, emrin dhe vendin e zënë ndonjëherë jo drejtësisht në kulturën shqiptare, por miqësinë e sinqertë, raportet njerëzore, pa tjetër kulturën, talentin si krijues e premtimin për kohët që do të vinin. Dhe Lasgushi që nuk të afronte lehtë, nuk gaboi aspak, kur zgjodhi Moikomin si mik, madje dhe mik shtëpie, ku e priste shpesh me bashkëshorten (e cila shkruan me aq admirim). Patjetër dhe i besonte, ndiqte krijimtarinë e tij, e lexonte me kujdes, mbante shënime e bënte vlerësime për të, gëzohej për suksesin dhe e inkurajonte...

Në këtë libër bëhen bashkë liriku i papërsëritshëm Lasgush Poradeci dhe autori, një njeri erudit e krijues i veçantë sot.

Është mbresëlënëse mënyra si e përshkruan Moikomi vetminë e poetit, jo thjesht si një dramë personale. Autori të bën të kthehesh pas në kohë e ta ndjesh atë. Është gjetje, cilësimi i poetit si “vetmi publike”. Lasgushi enigmatik, i sëmurë që i ri, mund dhe të kishte vdekur herët, ashtu si Migjeni, por ai e ‘mposhti’ sëmundjen e jetoi gjatë si De Rada.

Përshkrimi që Moikomi i bën shtëpisë (“kullës”) në Pogradec, vjetërsisë, orendive, shkallëve e dërrasave që kërcisnin kur ecje, apo diçkaje nga jeta e sjellja e poetit atje, të bën që të duket sikur dhe ti e shikon, sikur po hyn në atë shtëpi, sikur dëgjon kërcitjen e dërrasave e shikon Lasgushin e plakur duke shkruar a lexuar...

Janë aq domethënëse vizitat e herëpashërshme tek memoriali i të rënëve në Pojskë; dy poemat për vëllezërit Çollaku rënë heroikisht në luftë; interesi për mozaikun në basilikën e vjetër të Linit; apo për vendbanimin e hershëm në pjesën liqenore pranë fshatit Buqezë, etj...

Libri i Moikomit është biografik e njëherësh studimor. Është për Lasgushin dhe njëherësh për personalitete të tjerë shqiptare e botërore. Është historik e njëherësh shëmbull si duhet trajtuar e kaluara e letërsisë shqiptare. Ky libër i kalon edhe kufijtë kulturorë të asaj që mund të përkufizohet “lasgushiane”. Aty gjejmë e mësojmë shumëçka tjetër që lidhet me mitologjinë, me antikitetin,

me artin europian, me letërsinë, me figura e personalitete të së shkuarës apo të kohës së krijimtarisë së Lasgushit.

Nga libri mësojmë vlerësimet e shumta pozitive, të talentit e krijimeve poetike të Lasgushit, nga personalitete të kulturës shqiptare si Çabej, Luarasi a Kuteli, por gjejmë edhe kritika, madje ndonjëherë me tepëri ndaj fenomenit Lasgush. Dhe jo nga njerëz dosido, por me emër e nivel kulturor si Krist Maloki, Sejfulla Maleshova e deri tek Fatos Arapi... Kështu Moikomi na bind edhe për diçka tjetër që s’duhet anashkaluar, se vendi që zuri Lasgushi në krijimtarinë moderne poetike shqiptare, nuk ka qënë e kadifentë...

Trajtimi që i bën Moikomi shëndetit të Lasgushit, por dhe qëndrimit të tij ndaj sëmundjes së herëshme, spjegon jo pak nga sjellja e tij në jetë. Duke e vënë në një sfond më të gjerë, nga përvoja e raporteve të ndonjë personaliteti botëror me sëmundjen, si Kafka, autori na e lehtëson gjykimin. Njëherësh dëshmon forcën e karakterit të Lasgushit, që edhe në rrethana të disfavorshme ekonomike, politike e shëndetsore, ai ka mundur të qëndrojë në këmbë, që duke përdorur fjalët e tij në një poezi, dhe mund të jetë “hepuar”, por nuk është “rrëzuar”.

Korespondenca e Lasgushit me miq të shquar, veçanrisht ajo me Çabejin, Asdrenin, Kutelin, Luarasin, etj, është mbresëlënëse, për nga thellësia e mendimit, dashuria për shokun, sinqeriteti shpirtëror, mungesa e cmirës e xhelozisë, etj, që rrallë gjenden kaq të pastërta e me këtë përmasë në sfera të tilla të fushës së krijimit e të studimit... Të mbetet në mendje poezia e Kutelit shkruar në Ukrainë në tetor 1941, si një testament në prag vdekje, që ia dërgon pikërisht mikut të tij, binjakut të tij Lasgush.

Por ndodh që edhe mes të mëdhenjve ndërlikohen marrëdhëniet. Se dhe ato kanë ulje ngritjet e tyre. Sepse dhe ata nuk u shpëtonin dot meskiteteteve njerëzore, në mjediset që i rrethonin apo lidheshin me ta. Si rasti me

motrën e Kutelit... Dhe megjithatë raportet njerëzore mes tyre, vlerësimet për çka kanë shkruar e arritur në jetë, mbeten të pacënuara.


Në këtë libër këndi i krijimit për Moikomin është i gjerë. Duke folur për “Antologjinë” e Lasgushit, ai bën pjesë të librit edhe mjaft krijues të tjerë shqiptarë, madje dhe të panjohur për lexuesin e thjeshtë. Pa u zgjatur në emra, do të veçoja gjetjen e Moikomit, që në formë dialogu, fjala e tij në 25 vjetorin e vdekjes së Kutelit, jo vetëm është e veçantë, por me të drejtë bëhet pjesë e këtij libri. Po ashtu përmendja, komentet e vlerësimet për figura të shquara të letërsisë, si Naim Frashri, Noli, Fishta, Mjeda, Koliqi, Migjeni etj, veçe e pasurojnë librin... Askush nuk do ta trajtonte si Moikomi poemën Kamadeva apo atë për Sokratin. Në këtë të fundit gjejmë edhe Lasgushin, mendimet e tij për fenë, për zotin, për gjyqin tokësor, por dhe për atë epror. Edhe për Lasgushin Zoti është e vërteta.

Moikomi, pa përsëritur kënd dhe pa i ulur vlerat studimeve e vlerësimeve të të tjerëve, në mënyrë origjinale por dhe tepër cilësore, i bën një analizë shkencore krijimtarisë së Lasgushit. Ai bindshëm argumenton se pse është i madh e i papërsëritshëm Lasgushi si poet. Kuptohet jo nga kohëzgjatja e krijimtarisë, as nga sasia e veprave, por nga cilësia, nga forca, nga vlera, nga bukuria artistike... Moikomi sjell shëmbuj se si edhe me pak krijime, madje dhe me një të vetëm, njerëzit janë bërë të famshëm...

Lasgushi për Moikomin krijoi poezitë më të mira shqiptare të dekadave njëzet-tridhjet të shekullit të kaluar. Por ai është unikal, nuk përsërit askënd. Madje dhe më pas në një farë kuptimi ai përsërit vetëm veten. Por veten ama, askënd tjetër...

Si askush më parë, Moikomi nxjerr në pah karakterin atdhetar të krijimtarisë së Lasgushit. Ajo fillon me kontributin e tij në letërsinë e kulturën shqiptare. Më tej me qëndrimin ndaj gjuhës e çka bëri ai për ta pasuruar e lartësuar shqipen. Por atdhetarizmi duket dhe tek lënda e poezive të tij, që është vendlindja, Pogradeci e liqeni, Mali i Thatë, e kroi i fshatit, shtergu plak e natyra e vendlindjes... Dy poemat për bilbilin kombëtar Naim Frashërin, apo vlerësimet që u bën rilindasve të mëdhenj si luftëtarë e krijues, nuk janë pa domethënie të fuqishme atdhetare. Ashtu siç mund ta gjesh atë edhe në ndonjë letër të thjeshtë si ajo e 15 gushtit 1969, për kushëririn e tij Thoma Gusho në Detroit të Amerikës, ku nuk harron ti kujtojë emigrantit shqiptar, etrit e tyre.

Me këtë libër dinjitoz, Moikomi i bën një nder të madh figurës së Lasgush Poradecit, por ai lartëson më tej edhe krijimtarinë e tij. Një krijimtari e gjerë, e larmishme, cilësore, atdhetare... Krijimtari e një personaliteti erudit e të talentuar të kulturës shqiptare sot e më pas.



SHËNIME MBI POEZINË E BASRI ÇAPRIQIT

nga Sadik Bejko

Vdekja e autorit bën atë që të hiqen mendime përfundimtare për një vepër që tashmë quhet e kryer. Kështu po ndodh dhe me Basri Çapriqin. Vepra e tij po rilexohet. Edhe më tej ajo duhet mbledhur, botuar dhe studjuar si vepër e përfunduar.

Me kohë është vënë re se Basri Çapriqi krijoi dhe botoi në vazhden e mjedisit poetik të poetëve të Kosovës. Një poezi në ujërat e hermetizmit, të shenjave që më shumë fshehin sesa thonë, një poezi që ndien muret, terrin, asgjësimin, tëhuajëzimin dhe merr guximin të marrë frymë, të ikë nga terri, “ta lërë dritaren hapur”.

Bashkohem me atë që Çapriqi erdhi me prurjet e veta në poezi. Thuhet se ironia ishte cilësia më e rëndësishme e kësaj poezie, thuhet se ajo ishte poezi e mjediseve urbane, përkundër asaj që poezia shqipe përgjithësisht ka sjellë mjedise rurale. Thuhet se ajo u largohej temave të patetikës, të miteve nacionale që e kanë dominuar poezinë tonë.

Për mendimin tim, poezia e Basri Çapriqit, pa i mohuar me një të rënë të lapsit, pa i pohuar kallëp ato që janë thënë mbi të, ka qenë një poezi në kapërcyell. Ajo ka shënuar disa nga realizimet e saj më të mira në tematikën urbane, por ka lëvruar me shumë sukses dhe motivet e detit, të ullirit, të ujit, tema që janë më afër përjetësisë, më afër motive të përjetshme, sesa trajtimeve të tyre si motive të urbanizmit apo të rurales.

Poezi e anktheve dhe terreve në një anë, por motivet e kthjellësisë me dritë e paqe, me det e me pulëbardha në anën tjetër, kontrastonin, thyenin e njëherësh dhe e pasuronin verbin tërësor të poezisë. Vërejmë këtu se nuk ka rëndësi sasia numerike e poezive, por ajo e arritjeve, e cilësisë. Cilësia e shkrimit shpesh anon nga motivet detare të kësaj poezie.

Janë vënë në shenjë poezitë e tij të ironizimit me lirinë, me luftërat glirimtare, me At-dheun e me të tjera tema tabu, që në një interval kohor mund të kenë tingëlluar si blasfemi ndaj miteve të shënjtëruara nga poezia jonë e traditës dhe nga ajo që ende shkruhet. Pa dashur të themi se këto theksime ironike, në mos qofshin pozime – dhe në fakt nuk janë të tilla – në thelb e më drejtë mund të jenë protesta e një të lënduarit, e një të zhgënjyeri. Dihet, që protesta qoftë ajo dhe si blasfemi, e bën edhe më të rëndësishme atë që blasfemon. Blasfemia e vë në qëndër, e sheh nga këndvështrime të panjohura më parë atë që poezia e mëparshme e ka glorifikuar.

Marrëdhënia e autorit me tema të tilla prapë mbetet, por e shfytëruar si në lidhjet fatale e të pashkëputura, si në rastet e dashuri-urrejtjes.

Poezitë për Ali Podrimjen, për Lasgushin, për poetë të tjerë, për Shasin, për Tivarin e çojnë poetin Basri Çapriqi në tragat e atij kapërcyelli që ai u mat ta kalojë përtej e prapë mbeti midis. Mitet ende mbeten pjesë e poezisë së tij.

Edhe blasfemitë poetike të Çapriqit aty i ke, janë dhe mbeten guximi, risia dhe merita e tij e patjetësuar.

Në veçanti shquhet poezia e gjendjeve të ankthshme, e haluçianantes. Në këto poezi grotesku të çon nga thyerja e tragjikes, nga absurdi, nga rënia në pa rrugëdalje. Organizimi gjuhësor në këto poezi është derdhur në një ligjërim të thukët si endja e dendur, si thurja e rëndë e qilimit në vekun tradicional.

Këtu do të veçoja si mjet shprehës përsëritjen, por edhe mjegullimin e kuptimit nëpërmjet thyerjes së rendit sintaksor të frazës, mungesës së pikësimit, përmbysjes e rimarrjes së një togfjalëshi a të një njësie frazeologjike. Përsëritja meriton një vështrim të veçantë për funksionet, për pasurinë, dendurinë e gjerësinë e përdorimeve nga poeti.

Poezia në mënyrën si e shkroi Basri Çapriqi e pasuroi, e bëri më të zhdërvjelltë, më shprehëse gjuhën, ligjërimin poetik.

Me poezitë me temë ujin, detin, kalimeret, Bunën, ullirin poeti u ka bërë nder, u ka bërë vend imazheve mesdhetare nga vendlindja. Me kohë, mundet këto cikle të detit mund të zgjeroheshin e të kishim një topik të ri në hartën e poezisë shqiptare, topik si liqeni i Lasgushit, si Zvërneci i Fatos Arapit. Ndryshe nga Lasgushi e Arapi poezia me motivet e ujit e Çapriqit i kreh, i filtron, i avullon detajet konkrete të mjedisit për të fluturuar në metafizikën e së shëndritshmes, të së pambërritshmes, të së mistershmes.

Një dimension tjetër jo shumë i rrahur, apo i panjohur më parë në poezi, vjen me poezitë mbi sendet, si jastëku, kuzhina, teli i rrobave, dera etj. Kjo prirje e minimalizmit, prirje nga poetizimi i së rëndomtës, i jopoetikes, prirja nga poezia e pastër, poezia lojë e formës, lojë e fjalës, merak ky i poezisë moderne që nga Rembo e tëhu, ka sjellë një poezi të përkryer si “Jastëku”, një poezi e përfaqësuar në disa antologji.

Këto janë disa nga arritjet më të spikatura të tij. Studimi i veprës së Basri Çapriqit sapo ka filluar. Më sipër parashtrova leximin tim, ndalesën shkurt te dimensionet më kryesore të kësaj poezie: motivet e detit, motivet e ankthit, të ironisë dhe të minimalizmit.

2.

Ora e fatit Basri Çapriqin e ndali kur ai ishte një burrë plot energji, një krijues në kulmin e forcave të tij.

Vepra, që ishte ende në duart e tij, për t’u ndërtuar, për t’u përkryer, tashmë quhet e përfunduar.

Si poet me fat ai u pranua herët në sofrën e në vatrën e më të mirëve të mjediseve të veta. Poezia e tij u përfshi në antologji, u përkthye në disa gjuhë. Ajo u përfaqësua dhe në mediumet poetike të PEN Internacional.

Vendlindja atë e ka dashur, e ka kujtuar dhe nderuar në Kalimerat poetike, në konferencat shkencore në kalanë e Ulqinit.

Më tej po vazhdohej me promovimin, me studimin e veprës së tij poetike, me evidentimin e personalitetit kulturor të poetit, të pedagogut, të veprimtarit e studiuesit Basri Çapriqi.

Deri këtu gjithëçka shkon mirë. Dhe....

.... dhe është e lehtë ta shkruash e ta botosh poezinë kur ende je gjallë, por sa vështirë që ajo të mbetet mbas teje, kur ti të kesh ikur nga kjo botë.

Këtë e them se para se të bëja këto shënime, lexova edhe një herë nga e para Basri Çapriqin, rilexova dhe poetë të tjerë pranë Basri Çapriqit, poetë që sot nuk janë më. Vdekja na bën të gjithëve të brishtë. Tash jemi gjallë, mbase dhe të pushtetshëm, po çfarë mbetet nga vepra jonë kur shkojmë në atë që mund ta quajmë asgjë?

Pyetjes se çfarë mbetet nga një poezi kur ajo shkëputet nga mjedisi i vet, kur ajo ndahet nga autori i vet për t’u shkrirë në rrjedhat e krejt letërsisë shqipe, mund t’i dilet përballë me një përgjigje.

Është një pyetje që lidhet me vlerat e poezisë, të letërsisë në tërësi.

Sipas mendimit të shumë shkrimtarëve dhe esteteve në botë, letërsia i jep publikut atë gjë që ai nuk e merr nga teologjia, nga filozofia, nga shkencat. Thelbi i qenies sonë, dhimbja, kompleksiteti i gjendjeve tona – po sipas këtyre esteteve – vijnë në letërsi përmes grimcave “të përshtypjeve të vërteta”. Pra, vlera e letërsisë qëndroka te sjellja e këtyre përshtypjeve të vërteta. Këto ide të Marsel Prustit, të Harold Bloom-it, të Saul Beloë-t mbi vlerën e letërsisë, dua t’i vë në dukje edhe në këtë rast, teksa lexoj poezinë e Basri Çapriqit e të poetëve si ai... poezinë e poetëve në tërësi. Dhuntia kryesore e tyre si autorë gjendet te aftësia në transmetimit artistik, në poezi a në prozë, të përshtypjeve thelbësore mbi njeriun, mbi mjedisin a mbi shoqërinë.

Përshtypjet e vërteta e të thjeshta ose grimca të tilla të sajara në atë cilësi sa të merren si të vërteta, qenkan lënda me të cilat ndërtohet ngrehina e tregimeve, e novelave, e romaneve dhe e përmbledjeve në poezi. Kështu imitohet jeta, apo njëmendësia e sajuar jetësore na vjen më e vërtetë se ajo që realisht quhet jetë dhe poezia e proza artistike gjithmonë mbeten një kërkim në përjetësi. Një kërkim nga çdo njeri që vë përpara një letër me synim shkrimin e bukur, me synim sajimin e shëmbëlltyrave të arrira të artit.

Përvoja e prurjeve të përshtypjeve të thjeshta e të vërteta nga mjediset jetësore e ka ngjyruar, e ka pasuruar e thelluar poezinë shqipe që nga fillimet. Përvoja e pështypjeve të thjeshta e të vërteta arbëreshe e shquan si të pashoqe poemën “Këngët e Milosao’s” të De Radës. Edhe më tej. Dihet ç’dhurata të çmuara i kanë ardhur poezisë shqipe me përshtypjet e vërteta e të thjeshta nga realiteti i nënës dhe i të dy bijave te poema “Andrra e jetës” e Ndre Mjedës. Me përshtypjet e vërteta e të thjeshta vjen si erë e re dhe e freskët në letërsinë shqipe poezia dhe proza e Migjenit.

Vijmë te një poet i modernitetit: Martin Camaj. Me një tërsi grimcash të vërteta a me një tërësi përshtypjesh të sajara njëmendësisht e thjeshtë sa ngjajnë si të vërteta, ai ndërtoi në mërgim mungesën e Dukagjinit, mungesën e vendlindjes. Asgjë nuk ngjan aq ngjethëse, aq mprehtësisht e vërtet sa mbresat që sjell kjo poezi e Martin Camajt.

Nuk po e zgjat. Me një lëndë të tillë si ajo e përshtypjeve të thjeshta e të vërteta poezia, proza mund të na çojnë te e përjetshmja.

16 Janar 2020



NJË HESHTJE PËR VDEKJE

ese

nga Rexhep Ferri

1.

Mes njeriut dhe njeriut, ëndrrat janë bërë mani.
Ata dhe Ne.
Të qeshurat dhe duartrokitjet me njëmijë e një
dredhi nga njëra rrumpallë në tjetrën.
Për të ringjallur mashtrime të reja.
Me biseda për nesër.
E me ndërgjegje për një kohë të harruar.
Nuk po di se kujt t'i them sa pak i ngajmë vetes.
Kudo që shkojmë.
Kudo që kemi pirë ujë.
Pse na duhet ta kujtojmë luftën, kur me gjithë
respektin për lirinë nuk e dimë se çka është lufta.
Mos më pyetni kot.
Lufta ka shumë kuptime.
Për famën e saj s'ka mbetur gjë pa u thënë.
Kërkojmë kohë për sot, kohë për nesër.
Shpesh nuk dijmë se çka kërkojmë.
Kurrë nuk u çliruam nga vetveteja.

2.

- Humbëm djemtë!
Humbëm burrat!
U vranë.
S'patën për kë të vriten.
Në Krushë të Madhe, pas njëzet viteve, tha nëna e
katër djemve të vranë.
Në shumë gjuhë të botës, të jetosh nuk do të thotë
se je takuar me realitetin.
Tani sojlinjtë po shiten si profetë.
Kuptimin e jetës e kanë siguruar me thellësinë e
xhepave të vet.
Me çfarëdolloj çmimi.
Edhe kur kthehemi nga drita e diellit Zotin nuk e
pyesim për asgjë.
S'ka kohë për të humbur për ne.
Për ne që me fluturimin e ëndrrave mashtruese
nxitojmë për ta mbyllur ditën.

3.

Deri sot veten e kam konsideruar botë.
Por tani ku ta gjej pasqyrën që më paska mashtruar
kaq shumë vite.
Gjithsesi për pak dredhi e për pak politikë.
Për të zbardhur një rrezik kërcet tupani.
Te Ura e Qytetit i njëjti mashtrim. Mendonim se
do të bëhet mirë.
Me nga një fotografi dokumentare kaluam në
çmenduri.
Dy herë në ditë në gotën e ujit i qesim nga tri pika
helm.
Larg jetës dhe larg ëndrrave tona.
Sakrifikuam jetën e rrahur nga jeta.
Për kalimin e kohës e me kalimin e kohës, për t'i
dhënë kuptim jetës ende shohim ëndrra.
Kemi kohë, s'kemi botë tjetër.

4.

Njeriu sot nuk di se çka kërkon e çka humb.
I frikësohet komunikimeve.
Kur shkon më larg dhe kur e kalon vijën e kufirit
duhet t'i themi: Erdhëm!...
Ndoshta nesër.
Nuk e di se çka është më reale.
Shtrojeni drekën.
Për shoqëri të largët shtrojeni me supën e bërë nga
gjaku.
Shija e kësaj kërkesë është shije e rrallë...
Sa për ta kaluar urën e shekullit, e vërteta më e
mirë se e vërteta kapet me aparatit fotografik.
Kur na ra në dorë fotografia dokumentare, Hëna
ishite e plotë.
Te Deti i Gurit, për ta kuptuar përvojën e humbur
prapa shpine edhe shumëçka tjetër.

5.

Pasqyra pasqyres i tha:
- Dreka me supë të bërë nga gjaku, atyre që nuk
dijnë se çka të bëjnë me jetën e vet u shitet shtrenjtë.
Për të mashtruar syrin dhe për ta ngritur famën e
çmendurisë dhe për të bërë një përshesh me gjak, kjo e
papritur na vie si befasi.
Për të regjistruar një çmenduri.
Për aq sa e kemi dashur njëri-tjetrin.
Kujtesa ngeli atje ku e kemi harruar jetën.
Me dritë e me hije.

Në jetën tonë të përditshme.

Me anekdota të rrejshme morale, të cilave u kemi
besuar me vite.

Ndoshta ka qenë kështu siç e kuptojmë edhe
tani: Kufijtë e sjelljeve njerëzore rikuptohen dhe
riinterpretohen.

Ndoshta do ta gjejmë një kohë ashtu siç kuptohen
pesë sekonda të largët për hijet e njerëzve të humbur.

6.

Nuk kam as çka të them e as çka të sqaroj më
shumë.

Jam mësuar t'i besoj edhe djallit.

Gjatë imazhit publik, kur e presim armikun, a jemi
të vdekur?!

Pas një takimi me gjithçka tjetër, për diku tjetër?

Edhe kur jetën e kemi në fije të perit.

Vitet shkojnë.

S'ka kush të na thotë se njeriu është idiot.

Por ndryshimet ku i lamë?

S'kemi shumë ide.

Të bëjmë një eksperiment.

Një heshtje për vdekje.

Kur ngjitemi te majat e Bjeshkëve të Nemuna, jeta
ka nevojë për vetëbesim.

7.

Imazhi publik është magji.

Çfarë gabimi!

Më falni që nuk ju kam takuar më parë.

Kend ta njoftoj se ku jemi.

Njerëzit e tjerë flasin kot.

Nuk është dashur të presin me vite, me muaj.

Si mendoni?

Askush nuk na detyron t'i lutemi Zotit, bërë Zot
mire.

Dhe a do të ndodhë edhe ajo që s'e kemi pritur.

Për të bërë një pshesh me gjak, borxhet do t'i
paguajë e Bukura e Dheut.

Si me magji e korruptuam edhe Zotin.

Avokatët e mbyllën gojën.

Propozuan senacë të re.

Pritet të ngordhë gomari apo të vdesë mbreti.

Janar, 2020



TRANSISTORI

tregim nga
Adil Olluri

Dje më humbi diku transistori im. Transistori i luftës. *Radioni* i vogël i lajmeve të luftës. Për njëzet vjet rresht e kisha ruajtur si kujtim të bukur të një kohe të mynxyrshme. U mërzi shumë, po aq sa ditën kur e dëgjova lajmin për përfundimin e luftës.

Paramilitarët serbë nuk kursenin gjë. Nuk e lanë në këmbë asnjë shtëpi në fshatin tim. Nuk falnin asnjë frymor që nuk e fliste gjuhën e tyre. Jeta e një shqiptari për ta kishte më së paku rëndësi. Askush nuk guxonte të qëndronte në shtëpi. Fshati im dhe fshatrat e tjerë përreth qenë shpërngulur në mal. Një luginë mes dy kodrinash qe shndërruar në strehë shpëtimi për shumë e shumë shpirtra. Një luginë e mbushur me shatorre, që u shndërruan për disa muaj në shtëpiza prej najloni.

Shpirtrat ikanakë dëshironin të dëgjonin lajme. Të dinin se ç'po ngjet përtej luginës. Të dinin se edhe sa do të zgjasë lufta. Edhe sa mund të përfundojë ajo?! Nuk kishin se me çka dhe ku t'i dëgjonin lajmet. Në tërë luginën vetëm unë e kisha një transistor të vogël, që e mbushja me akumulatorin e veturës së tipit "Jugo".

U mor vesh se unë e kisha atë që e kërkonin për dy ditë me radhë. U mblodhën të rinj e të vjetër pranë tendës sime.

O djalo, o djalo! - më thërriste mixha Fetah, duke mos dashur të hynte brenda, -

Hajde lëshona *radionin* e ta ngojmë naj lajm! - më thërriste mua, duke e ditur që babai ishte i paralizuar dhe nuk mund të lëvizte.

I dëgjuam lajmet e pasdites në një radiostacion, të cilit nuk ia mbaj mend emrin. Kanë kaluar njëzet vjet dhe shumë gjëra i kam harruar. U ulën të rinj e të vjetër pranë shtëpizës sime prej najloni. Në fillim ishin

njëzet burra, por nga çasti në çast numri i tyre u shtua. U bënë tetëdhjetë e pesë vetë. Të gjithë heshtnin, përpos transistorit tim. Ai e bënte ligjin aty. Të gjithë i bënë veshët katër. Nuk donin t'u ikte as edhe një fjalë e folësit të lajmeve. Transistorit herë pas here i humbnin valët. Atij i humbte zëri, ndërsa dëgjuesve u vinte. Pasonin britmat në drejtimin tim.

Mbaje mirë, o djalë! Bash kur u përmend NATO, ti e livrime - foli mixhoku dhe pas

tij, thuajse të gjithë, më bënë fajtor për humbjen e valëve.

Bash në lajmin ma të madh, ti nuk dijte me majtë mirë.

Qysh me e marrë vesh tash se? - përziheshin zërat, sa që nuk e dija se kush fliste më

shumë e kush më pak.

Të gjithë më pyesnin për lajmet. Isha bërë lajmëtar i luginës. Përcillja te të tjerët çdo gjë që dëgjoja në transistor. I dëgjoja thuajse të gjitha edicionet. Shëtisja me transistor në dorë rreth e rreth luginës. Më kishte dalë nami shkaku i transistorit. Isha bërë edhe i rëndësishëm, po aq sa komandanti i zonës sonë. Shpeshherë ndodhte që për luftën, më shumë të më pyesnin mua se sa atë. Të mos flasim për ushtarët e tjerë. Nuk i qaste kush kur isha unë aty.

Më pëlqente të më pyesnin për lajmet. Më së shumti më pëlqente kur më pyesnin vajzat. Mbaj mend të kem shëtitur me transistor në dorë vetëm e vetëm të më pyesnin ato, veçmas Linda. Ajo ishte tetëmbëdhjetë vjeçe, një më pak se unë. Trupi i saj i gjatë dhe flokët e saj të bardha ishin i vetmi shkëlqim në atë luginë, ku i plaknim ditët si beduinët e shkretëtirës.

Tenda ku ishte e vendosur ajo ishte rreth dyqind metra larg simes. Nuk kalonte një orë që të mos rrugëtoja andej me transistorin tim, vetëm e vetëm të më fliste ajo. Të më pyeste se ç'thoshin lajmet, sikur të gjithë të tjerët. Por, jo. Në vend të saj dilte herë babai, herë i vëllai, herë-herë edhe ndonjëri nga kushërinjtë e saj. Megjithatë, nuk hiqja dorë. Sërish e sërish kaloja andej. Sërish e sërish të njëjtit njerëz pyesnin. Thënë të drejtën, sa herë që nxirrnin kokën nga shtëpizat e tyre prej najloni, i shaja nëpër dhëmbë, përkundër se ishin familjarë të vajzës që e pëlqej. Kokat e tyre më ngjallnin neveri.

I dëgjova dy motrat e mia tek thoshin se Lindën e pëlqente njëri nga çlirimtarët, ushtari B., që kishte tri vjet më shumë se unë. Motrat thoshin se do të fejoreshin fill pasi të përfundonte lufta. Nisa ta urreja ushtarin B. Do ta ngulfasja po ta kisha afër. Do të isha i pasinqertë nëse nuk do t'ju tregoja se ai ishte i vetmi ushtar që doja të vdiste në betejë me serbët. Aq më bënte po të vritej. Me rëndësi ta bëja Lindën timen.

Prapëseprapë, nuk hoqa dorë. Doja t'i flisja Lindës dhe ta bindja se unë jam më i mirë se ushtari B., se ai nuk është asgjë karshi meje. Shëtisja andej me të njëjtin ritëm si më parë.

Erdhi çasti i shumëpritur dhe Linda, më në fund, doli nga shtëpiza prej najloni. M'u afrua dhe nuk më shikonte aspak mua, por transistorin tim.

A mujmë me digju edhe muzikë me ta? - qe e vetmja në luginë që nuk më pyeti

për lajme.

Po, mujmë. A ta lëshoj mejherë? - pa humbur kohë fillova të gjurmoja në

radiostacione të ndryshme që mund të lëshonin muzikë.

Jo, tash nuk kam kohë se duhet me i ndihmu nanës. Nesër n'mbramje hajde knej

edhe ngojmë muzikë. Moti nuk kam ngu. Dësh sa fluturova nga gëzimi kur i dëgjova këto fjalë. Kanë kaluar njëzet vjet dhe asnjë fjalë nuk më ka tingëlluar më ëmbël se sa ato të asaj paradite.

Isha më shumë se i lumtur. Do të dëgjoja muzikë me Lindën. Do t'ia thosha të gjitha. Mezi prisja të ikte kjo ditë dhe të vinte mbrëmja e së nesërmes. Bëja prova me transistorin tim për ta gjetur radiostacionin me muzikën më të mirë. Babai, nëna, vëllai dhe motrat habiteshin dhe e shikonin njëri-tjetrin. Befasoheshin se si më erdhi kjo dëshirë për të dëgjuar muzikë me orë të tëra. Deri në këtë çast, pos lajmeve nuk dëgjoja gjë tjetër.

Duke gjurmuar radiostacioneve, dëgjova lajmin se lufta tashmë kishte përfunduar. Hyrja e trupave të NATO-s në Kosovë ishte çështje orësh. Pa humbur kohë i njoftova së pari kushërinjtë, për të vijuar me thuajse të gjithë që i takoj në luginë. I kishte ardhur fundi. Do të niseshim në shtëpi. Fshatarët donin të zbrisnin menjëherë në fshat, po sugjerimi i komandantit ishte që të prisnin deri nesër.

Gjatë paradites të së nesërmes u shëtita si gjithnjë rreth e rreth luginës. Askush më nuk pyeti rreth lajmeve. Askush më nuk më qaste. Madje, as që më përsëhendesnin. Tri herë i rashë rreth e rrotull luginës, por njëjtë. Askujt më nuk i duheshin lajmet e transistorit tim. Askujt më nuk i duheshin unë. Të gjithë bëheshin gati për t'u kthyer në shtëpitë e tyre. Askujt nuk i binte ndërmend për mua. Nisi të më mërzi ky fakt. Më nuk isha ai djali me transistor. Djali i lajmeve. Isha thjesht njëri nga djemtë e luginës që po e linim. Nuk guxoja t'ia pranoja vetes, por thellë në shpirt nuk më pëlqente përfundimi i luftës. Mërzi m'u shtua kur m'u kujtua se pikërisht sontë do të dëgjonim muzikë me Lindën. Nuk do të kishte më mbrëmje të muzikës dhe ndoshta të nesërmen ajo edhe do të fejohej.

Më kaploi një ndjesi pikëllimi dhe tri herë u mundova ta hidhja në një gurinë mali transistorin tim. Nuk munda t'ia bëja këtë. E mora me vete dhe u nisa drejt tendës sime.



VEZA E ZEUSIT

tregim nga

Panos Ioannides

Lidës, pas dasmës që bënë, Suani i premtoi se gjatë lindjes së fëmijëve të tyre ai do arrinte të siguronte, me çdo kusht, leje nga mjekët me qëllim që të gjendej pranë saj gjatë lindjes, se do t'i shtrëngonte dorën, do t'i ledhatonte ballin...

Kur Lida mbeti shtatzënë në fëmijën e tyre të parë, Suani mori, vërtet, lejen që kishte kërkuar nga mjeku i saj gjinekolog. Por në kohën që ajo lindi, nuk rastisi që ai ta mbante premtimin që kishte bërë. Ndodhej me shërbim jashtë vendit dhe paçka se programoi që të kthehej në kohën e duhur, lindja ndodhi dy ditë më shpejt nga sa kishin përlogaritur, një ditë përpara se Suani të kthehej nga jashtë. Lajmin e madh të lindjes së fëmijës ai e mësoi përmes telefonit, nga motra e Lidës.

-Urime! Na erdhi në jetë një vogëlushe e shëndetshme. Ju lumtë!

Kur u kthye në ishull, përpara se të merrte valixhen e vet nga taksia, Suani vrapoi drejt e në klinikë. Hyri me vrull në dhomën e Lidës dhe ende pa u përshëndetur mirë e mirë me të, shkoi te krevati i vogël ku ndodhej foshnja. Një infermiere, e përkulur mbi krevat, po pudroste trupthin e njomë dhe ezmer të foshnjës.

-T'ju rrojë! - e uroi infermierja - Shikoje, a nuk është e bukur si kukull?

Foshnja ishte lakuriq dhe duart e saj të ligura dhe këmbët e vogla dridheshin. Hijet e tyre, ashtu siç binin në sipërfaqen e murit, i kujtonin Suanit diçka nga karkaleci dhe teatri i hijeve. "Bravo, karkalecthi im", pëshpëriti ai. U përkul dhe puthi barkun e butë të foshnjës. Buzët e tij u mbuluan me pudër, ndërkohë që lumturisht thithte aromën e këndshme të një jete të re dhe të freskët, që vetëm një ditë më parë kishte dalë nga mitra e nënës së vet.

U afrua pranë gruas, e cila ndiqte në heshtje veprimet e tij, dhe e puthi.

-Ia dole mbanë më në fund dhe erdhe? - e pyeti Lida, me një ton ironie.

-Po, ia dola! Por edhe ti ia dole mbanë, madje më mirë se unë!

Kur pas një jave priti në shtëpi Lidën dhe vogëlushen Eleni, -"Karkalecthin", sikurse e quanin me përkëdheli - ai u betua sërish se në lindjen e fëmijës së dytë, por edhe të fëmijëve të tjerë që mund të vinin në jetë më pas, do ta mbante premtimin që kishte dhënë për të qenë pranë saj gjatë kohës që ajo do lindte.

Shtatzania e dytë, që erdhi dy vjet pas lindjes së Elenit, i bëri shumë të lumtur ata të dy, burrë e grua. Dhe kur një ditë asaj i filluan spazmat, Suani u gjend menjëherë në klinikë bashkë me gruan që priste të sillte të jetë fëmijën e dytë.

Gjinekologut, i cili i priti në zyrën e vet, Suani i kujtoi premtimin që kishte mundur t'i shkëpuste përpara dy vitesh. Mjeku, që vetëm sa për t'i përshëndetur doli dy minuta nga salla e lindjes, ku po kulmonin dhimbjet e lindjes së një gruaje tjetër që pritej nga çasti në cacst të sillte në jetë foshnjën e vet, i tha Suanit: "sigurisht që e kujtoj". Më pas mjeku ia dorëzoi Lidën ndihmësit të vet, që ta shoqëronte te dhoma e fjetjes dhe ta përgatiste për lindjen. Suanit

i sugjeroi që të priste te salloni, në katin e parë të klinikës:

-Dhe mos u merakos. Do vi unë personalisht dhe do të njoftoj...

Suani, nën ethet e padurimit, u detyrua dhe zbriti në katin e parë dhe zuri vend në dhomën e ndenies, ku një burrë i ri, i panjohur për të, po priste, me duar, dhëmbë dhe gjunj të shtrënguar fort prej ankthit. Nga një kat më lart dëgjoheshin vazhdimisht klithmat e forta dhe depërtonjëse të një gruaje që po lindte.

Gjaku i Suanit ngriu.

-Bashkëshortja juaj? - pyeti të panjohurin, thuajse duke u dridhur edhe ai vetë.

Burri i ri tundi kokën në mënyrë pohuese, dukshëm i përfshirë nga një shqetësim dhe ankth i madh.

Ankthi dhe agonia e atij burrit të ri nuk zgjatën më shumë se disa minuta. Një infermiere zbriti me vrap shkallët, u afrua pranë tij dhe me një buzëqeshje të plotë i komunikoi se gjithçka kishte shkuar përmrekulli dhe se ai mund të shkonte dhe ta shihte nga afër gruan dhe djalin e vet në dhomën e tyre. Befas i riu shpërtheu në një të qeshur dhe të qarë njëherësh, diçka sa komike aq edhe për të ardhur keq, pastaj përqafoi dhe puthi infermierën, shtrëngoi fort dorën e Suanit dhe me vrap ngjiti tre e nga tre shkallët...

Tashmë i mbetur vetëm dhe i pushtuar prej ankthit, Suani po priste me padurim radhën e vet, që ta thërrisnin të ngjitej sipër, në sallën e lindjes. Priti një pesëmbëdhjetëminutësh të pafundmë, që më pas u bë një gjysmë ore dhe që arriti deri një orë e plotë. Zemra



gati sa nuk po i çahet. Dridhej i tëri dhe mbulohej nga dërsët.

Pas një ore e pesë minutash u duk, më në fund!, gjinekologu, që mbante veshur uniformën e vet.

Suani u derdh me vrap drejt tij.

-Tani është radha e saj, doktor?

Doktori vuri buzën në gaz: "Ah, i dashur... Çfarë të të them më parë? Lida lindi...Po! Lin-di! Ishte lindja më e lehtë në tërë karrierën time. Fëmijën e nxorri jashtë brenda vetëm dhjetë minutash! Përpara se unë të mundja t'ju thërrisja... Gjithsesi urime! U bëtë me djalë..."

Suani, që qante dhe njëkohësisht thithte hundët, vrapoi si era drejt e te dhoma e lehonës. Lida mbante në krahët e saj foshnjën e porsalindur. Suani e puthi, i përkëdheli flokët. Lida ngriti disi me vështirësi foshnjën topolake dhe ia tregoi Suanit. Ishte bjond, buçko, gjithë pala. Nëna dhe foshnja e porsalindur i kujtuan atij piktura të Madonës me foshnjën, të piktorit të famshëm Rafaelo...

"Betohem se në lindjen e fëmijës sonë të tretë do ia dal mbanë që të jem i pranishëm në çastin e lindjes..." përtypi fjalët e tij Suani.

"Nuk e besoj..." u përgjigj Lida me një buzëqeshje enigmatike, të mvëshur me ironi. "Për më tepër, Suan, pas djalit tonë Polydefkis¹, nuk do na vijnë më fëmijë të tjerë..."

-Nga e di ti këtë?

-E di... Veza e Zeusit u thye...

Deshte, s'deshte, Suani e kapërdiu këtë.

*U shkrua më 11 Tetor 2019, në Nikosia, Qipro
Përktheu nga origjinali në greqisht: KLEO LATI*

¹ Ky emër e ka prejardhjen nga mitologjia e lashtë greke, dhe konkretisht nga një prej dy bijve të Zeusit - Shënim i përkthyesit.

PAK FJALË PËR SHKRIMTARIN PANOS IOANNIDES

Panos Ioannides lindi në Amohosto të Qipros në vitin 1935.

Studjoi për Mjetet e Komunikimit Masiv në SHBA dhe në Kanada.

Punoi si shef i Radios dhe Televizionit në Radion Publike të Qipros, nga ku më 1995 u lirua nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Programacionit.

Është kryetar i Qendrës së Shkrimtarëve Qipriotë PEN, kurator i botimeve të Qendrës dhe kryeredaktor i revistës kulturore *In Focus*, që del çdo tre muaj në anglisht.

Filloi të shkruajë dhe të botojë vepra letrare, në fillm poezi dhe teatër, qysh më 1955, në moshën njezetëvjeçare. Që nga ajo kohë vazhdon papushim përpjekjen e tij letrare. Shkroi dhe botoi tregime, romane, vepra teatrore, përmbledhje me poezi, si dhe një numë të madh serialesh radiofonikë dhe televizivë si dhe skenarë. Vepra të tij janë përkthyer dhe botuar në tërësinë e tyre ose pjesë të shkëputura në disa gjuhë të huaja.

Është nderuar disa herë me çmimin Shetëror të Prozës, me çmimin *Thodosi Pierides* dhe *Tefkrou Anthia*, me çmimin e Kontributit Global të E.L.K. "G.F. Pierides" si dhe me çmimin e dramës televizive për veprën e Gregory në Konkursin Paneuropian të Sofjes në vitin 1976.

Në vitin 2007 atij iu akordua medalja *Nderi i Letrave*, që është vlerësimi më i lartë shtetëror në Qipro.

Nga krijimtaria shumë e pasur e shkrimtarit Panos Ioannides kam përkthyer në shqip trilogjinë e tij, dhe konkretisht romanet "Korbi", "Amerikë '62" dhe "Deva ose ëngjëjt mbrojtës të kafshëve", botuar nga Shtëpia Botuese OMBRA GVG.

THURIMA POETIKE SI PËRKRYERJE NË VIJIMËSI

(Variant leximi i poezisë “Kristal” të I. Kadaresë)

nga Tomorr PLANGARICA

Do ta orientojmë interpretimin tonë të poezisë “Kristal” duke pasur parasysh tre faktorë që mundësojnë interpretimin e këtij teksti poetik: a. Prirjen e natyrshme të lexuesit për t’iu përafruar paraqitjeve mendore të folësit në tekst; b. përfitimën e kuptimeve të reja, si pasojë e konceptimeve të rimodeluara nga nxitja e asosacioneve të pranishme në thurimën poetike; c. lidhjen e veçantë që përftohet në skenën thënësore me realen/referentin, jo si lidhje përshkruese, por evokuese, abstraktuese, jo për të gjetur një referent të drejtpërdrejtë, por më shumë një rrjet të hapur asosacionesh.

Përkimi i paraqitjeve mendore të interpretëve (autorit, tashmë dhe lexuesit)

Lexuesi i qaset tekstit të poezisë “Kristal” me përparësinë e zotërimit të një rrjeti të gjerë paraqitjesh mendore vetjake që janë natyrshëm të ruajtura në kujtesën e tij afatgjatë; ne memorizojmë përfytyrimet tona (ato që në psikologjinë kognitive quhen imazhe mendore) për objektet dhe botën që na rrethon. Ato janë njësi përfaqësuese në kujtesën tonë, të cilat paraqesin imazhe të objekteve reale. Këtyre imazheve ne gjithashtu u referohemi. Teksti i poezisë “Kristal” zhvillohet pikërisht përmes kësaj gjetjeje të imazhit mendor të diçkaje që provon mpakjen, largimin, vdekjen. Gjësëndit të vdekur i poetizohet riti i pasvdekjes. Në këtë rit, buthton më tej imazhi mendor i *kristalizimit* e *polenizimit*, që çon më tej te mosvdekja, mosharrimi, ruajtja, ripërtëritja. Imazhi mendor bart përparësinë e paraqitjes në mënyrë vijimisht të përpunuar. Ai mundëson që në ritin e pasvdekjes të bësh të pranishëm referentë shpirtërorë që mund të jenë pafundësisht të larmishëm (ndërsa ato perceptuale janë të përcaktuara). Këto përparësi shfrytëzon poeti, duke i endur shenjimet e tij me këto vlera subjektive të shenjimit të objekteve në tekst. Poezia përfshihet në një topos që ka rrjetin e tij të paraqitjeve, të pranishëm te lexuesi, si pasojë e përvojave vetjake ose leximore, kulturore e sociale; për më tepër, boshtet në të cilat është mbështetur struktura e poezisë, largimi, harrimi dhe vdekja, shqetësimi dhe përkuqjesja në ritin e pasvdekjes dhe ruajtja e ndjesisë përmes shndërrimit, metamorfozës a ripërtëritjes së llojit (brenda tërë rrjetit metaforik në tekst), përvijohen natyrshëm edhe përmes paraqitjeve vetjake të lexuesit, sepse ato gjejnë hapësira të konsiderueshme bartëse të këtyre paraqitjeve edhe tek ai vetë, në mendjen e tij. Pjesë e rizgjimit dhe rimodelimit të këtyre paraqitjeve, si pasojë e nxitjeve në tekst, janë edhe *procesi i kristalizimit*, që përftohet përmes shndërrimit të lëndës dhe ruajtja në atë gjendje të re të tipareve të vlerësueshme estetikisht, tashmë në pakohësi; ose të *polenizimit*, që përfiton po ashtu në pakohësi ruajtje të llojit e rigjallërim. Po ashtu, në mendjen e lexuesit zgjohen edhe paraqitje që kanë të bëjnë me forcën e artit për të ruajtur në përtejkohë ndjenjën dhe emocionin, apo paraqitjet e tjera mendore që kanë të bëjnë me përvojat e njeriut për të respektuar të dashurit po ashtu në përtejkohë, në pasvdekje, duke krijuar shenjtërimin e vendit të varrosjes apo duke i bartur atij edhe parapëlqime sociale e estetike.

Shenjat gjuhësore në thurimën poetike, si bartëse asosacionesh

Rikuptimësimin dhe rikontekstualizimin e tekstit e ndihmojnë më së shumti vetë përzgjedhjet gjuhësore dhe teknikat e përdorura në organizimin e tekstit, që duke u rimodeluar, të çojnë në mjete metaforike që rikuptimësojnë thëniet dhe mesazhet e bartura. Asosacionet e pranishme në tekst përlindin prej një rrjeti lidhjesh, të përfutur prej raportesh e teknikash formale gjuhësore e izotopike, të mbështetura në tipare semantike a sema, që synojnë: papërcaktueshmërinë dhe fluiditetin e përmasave kohore dhe hapësinore, që ndihmojnë për abstraktime, interpretime dhe asosacione më të shumta; dinamizmin e leksemave kyçe në thënie (për pasojë, aktivizimin e një rrjeti asosacionesh) që përftohet mes leksemave në kotekste të atypëratyshme gjuhësore a mikromjedise përdorimore që e drejtojnë vëmendjen drejt tipareve më të veçanta semantike, si dhe përfitimi i një rrjeti izotopik që i krijon koherencë mendimit dhe kohezion shprehjes së tij; gjithashtu, asosacione të pranishme, të përfutura prej përzgjedhjes së formave gjuhësore e modale të njësive gjuhësore që i largohen jo pak herë shenjimit të gjësëndeve konkrete a gjendjeve e situatave, që të çojnë te konceptet a klasat që ato u përkasin, duke ngjyruar tërë thënien me modalitete plotësuese.

Papërcaktueshmëria e përmasave kohore e hapësinore që karakterizon njësitë gjuhësore ka mundësuar përtejomethëniet e tyre, duke i zgjeruar hapësirën kuptimore të tekstit dhe duke i mundësuar atij polifonizmin në shprehje. Përmasat kohore në tekst vijnë me caqe tejet fluide; prej së shkuarës pa cak, në të tashmen (*ka kohë... tani...*) drejt një të ardhmejeje të mbrujtur në format e dëshirores, të cilat ia theksojnë këtë përmasë edhe më shumë në vijimësi. Për më tepër, formula e rrëfimitarisë *ka kohë...* ka veçantinë të lidhë çastin e rrëfimit me një të shkuar në të cilën lë të papërcaktuar përzgjatjen e veprimit, duke e drejtuar në këtë mënyrë përqendrimin e vëmendjes jo te koha dhe përzgjatja e saj (apo largësia kohore me çastin e ligjërimit), por te veprimi i foljes që mban peshën e predikativitetit të thënies (*shihemi/s’shihemi* – krahaso me “ka dy muaj/vjet... që shihemi/s’shihemi”). Duke qenë se përmasat kohore në raport me ndjenjën e dashurisë, ngjalljen e saj, mbajtjen e saj ndezur, mpakjen a harrimin (vdekjen) janë tejet relative, të papërcaktueshme, atëherë formula e një caku me kufij kohorë të hapur është më e përshtatshme.

Dhe në përputhje të plotë me këtë konceptim të shenjimeve kohore, është përvijuar edhe loja ligjërimore me përmasat hapësinore, shpërmasimin a fluiditetin e madhësisë. Qokat hapësinore (*poshtë, lart, e veçanërisht varr, mermer, morg-kristal, bon, fushë, lulanjë*), të përfshira në “lojën ligjërimore” në tekst, me role dhe funksione të përfutura në ato përdorime, mundësojnë përvijimin e kuptimeve që shkojnë përtej domethënies së tyre, mundësojnë kuptime të ngarkuara tashmë me tregues socialë, estetikë, etj. Leksemat *varr, mermer* e *morg-kristal*, në kontekstin e përdorur, bartin e përcjellin vlerën simbolike të një përvoje që lidhet me një mendësi e botëvështrim të caktuar: leksema *varr*, me domethënien karakterizuese normale “strehë e zakonshme në pasvdekje”, e përdorur në lidhje kontekstuale me deiktikon *asnjë*

(që pragmatikisht parakupton “të tërën, të gjithë, por njëherazi edhe mohim të tërësisë”), në fakt nuk të çon te gjësëndi konkret, i lokalizuar, por në një hapësirë më të gjerë, përlindëse, që të çon natyrshëm në konceptin fqinjë që përftohet prej përdorimit dhe domethënies së re të përfutur: *asnjë varr*, do të thotë asnjë vend i destinuar në pasvdekje, pra “(asnjë) *varrezë*”, si institucion njerëzor. Së dyti, këto leksema bartin e përcjellin një përvojë sociale që shpreh respektin kolektiv, përmes një shenje të vlerësuar shoqërisht tashmë, të përfaqësuar nga *mermeri*, lëndë a gur që dallohet estetikisht për bukurinë e shfaqjes dhe formave që mund të marrë pas punimit (e prej këtej, kjo përvojë është shtrirë edhe si përvojë e respektit individual/vetjak, në raportet e vlerësuar më intime e familjare); dhe së treti, në rritje të skajshme, këto përvoja të çojnë te *kristali (morgu-kristal)*, ku treguesit estetikë dhe metamorfoza e pranishme në përfitimën e tij, shfaqen sfidueshëm në status sipëror. Dhe për ta kontrastuar me këtë hapësirë tejet të humanizuar, por që nuk ka gjithësesi prani të përmasave të mëdha, poeti endet sërish në shenjime gjuhësore që do të bartin ato përmasa, madje sërish në kufijtë e së skajshmes: *boni*, me përmasën e thellësisë së papërcaktuar; dhe *fusha* e sidomos *lulanja*, sërish me këtë papërcaktueshmëri, në gjerësi tashmë.

E gjitha kjo marrëdhënie hapësinore që bart vlera kuptimore përjetimesh vetjake e sociale, rezonon dukshëm me shenjimet e hapësirave të një natyre tjetër, që kanë ardhur të metaforizuar në strofën pararendëse; konceptime që duket se vijnë nga lartësitë sublime të artit/arteve (*strofa*, pra, nga poezia dhe *nota*, pra, nga muzika), për të shkuar në lartësitë absolute estetike, pra, te *brilanti*, te vlerat e padiskutueshme estetikisht të tij; dhe nga lartësitë e realiteteve të tilla sublime, fillon kërkimi te hapësirat e përvojave më tokësore; kjo zbritje në diminuento drejt më tokësorës, është thjesht një efekt i parë, që me elementet sociale, e më njerëzore, do të përvijojë kurbën e thyer, tejet ndikuese emocionalisht prej kontrastit, për të vijuar më tej në gjetjen finale, me një raport tjetër shenjimesh jo vetëm hapësinore, por sërish të atilla që të bartin edhe proces lëvizjeje, zhvillimi, madje rigjallërimi e ripërtëritjeje, e përmes kësaj ripërtëritjeje, vijimësi të llojit në pafundësi, përmes polenit në lulanjë e procesit të polenizimit që siguron këtë lëvizje e ripërtëritje.

Ndoshta mund të gjejë shpjegim kjo marrëdhënie e pasqyrimin të hapësirës në tekst përmes papërcaktueshmërisë në lokalizimin e hapësirës, për më tepër shenjimin e klasës ose fushës semantike dhe fqinjësisë që krijohet mes elementeve në një shtrirje më të gjerë shenjimesh, në atë që Foucault-ja e konsideron si *prirje bashkëkohore* të vështrimit së brendshmi të hapësirës. Ndryshe nga ajo që mund të quhet hapësira mediane (e konceptimit në Mesjetë), ku mbizotëronte prirja e vendosjes sa më konkrete e vendeve në marrëdhënie varësie e përqasjeje mes tyre, një lloj shenjtërimi i hapësirës konkrete e të lokalizuar ngushtësisht, madje të sublimuar e në raporte të caktuara (vend i shenjtë-vend profan, hapësirë vetjake-hapësirë e grupit...), sot kemi, sipas Foucault-së një konceptim të ndryshëm, drejt një zgjerimi të këndvështrimeve tona, ku synohet të vërehet shtrirja, gjerësia, marrëdhëniet e elementeve të fqinjësisë që përftojnë kufij më të gjerë të vëzhgimit e konceptimit tonë. E, për më tepër, në lojën e papërcaktueshmërisë hyn si gjetje edhe konceptimi, me përmasa gati spekulative, i koncepteve që shenjojnë gjësëndet kyçe në tekst, si *poleni* dhe *kristali*: domethënia e *polenit* vjen te ne si diçka e vlerë, e brishtë, gati fluide, e pakët në shfaqjen konkrete të tij, ndërsa në poezi si diçka e pafund, që si tis mbulon a i jep gjallëri vetë ekzistencës së lulanjës; po kështu edhe *kristali*, i pamatë në shfaqjen e tij gjithësesi të vogël fizike, po aq i pamatë në nxitjen e përjetimit estetik të së bukurës; madje, me kureshtjejen asnjëherë të pashpresë për vlerat e tij; e për pasojë, në çdo rast, shumë mëdyshje, përsiatje. Në tiparet semantike të të dyja leksemave është e pranishme gjithësesi izotopia e *kujtim-mosharrimit*. Në fakt, është një pranëvënie a përqasje domethënëse: kristali, si koncentrim vlerash dhe ideal estetik, si përfitim që vjen përmes koncentrimin në kohë, ngjizjes dhe transformimit në kohë, deri në ngurtësim të lëndës me cilësi të re shumë të vlerë; dhe nga ana tjetër, poleni, që bart si tharm aftësinë shndërruese dhe ripërtëritëse,

që zhbëhet e përhapet për të krijuar vlerë në pafundësi. *Kristal-in* dhe *polen-in* i bashkon izotopia e shndërrimit të lëndës, që gjen shprehje në botën minerare përmes kristalit a brilantit, dhe në botën bimore, përmes lulnajës e polenit, izotopi të pranishme hershëm në përvojat letrare. Kjo përjasje e madhe në tekst është e pranishme në përmasa gjithësi jo kaq të skajshme në pranëvëniet “notë”, “strofë”, nga njëra anë, e “varr”, “mermer”, “hon” e “lulnajë”, nga ana tjetër.

Është interesante të vërehet që logjika e parashtrimit poetik ka kërkuar ta theksojë atë tipar të ruajtjes, duke e përqsaur me një tjetër gjetje që ka të bëjë me përzgjedhjen e një tipari semantik që shenjon të kundërtën e ruajtjes: “kërkim për të larguar diçka nga vetja”; ndaj në tekst është i pranishëm një rrjet foljesh si *lëshoj, vë, lë, hedh, shpërndaj*, por në një shkallëzim tejet domethënës, me një diapazon tiparësh semantike që shkon nga një shkëputje e dhunshme (*lëshoj, hedh*) deri te një marrëdhënie tejet e brishtë dhe përkujdesëse (*shpërndaj*); madje në lidhjet kontekstuale kjo brishtësi theksohet nga raportet me *polenin* dhe mënyrën e shpërhapjes së tij *butësisht*, që duke bartur embrionin e riprodhimit, rigjallërimit, krijon pamundësinë për shkëputje, largim a distancim (e për pasojë, vjen natyrshëm, edhe më e motivuar edhe kontekstualisht, dhe jo vetëm kontekstualisht, pasiguria për largimin dhe shpresa për mosharrimin.

Por polifonizmi i tekstit ndihmohet edhe nga elemente të tjera formale gjuhësore, si prania e harmonizuar e foljeve në lidhore (përmes të cilave shprehet dëshirë, mirësjellje) me foljet mirëfilli në dëshirë (të përdorura në thëniet kushtore që e nxisin ose e nxjerrin edhe më shumë në pah faktin që veprimi është tejet i dëshiruar); këto përdorime janë harmonizuar me tonalitetin e përgjithshëm të poezisë, ku në fakt, mëdyshja veçse fsheh një dëshirë: *mosharrimin*. Po ashtu përdorimi i konektorit *dhe* në kontekste që i mundësojnë atij të ndihmojë në përfitim e modaliteteve të ndryshme, duke përmbushur jo thjesht funksione shitesore, por edhe lejore, shkakore (*dhe*/ndaj/prandaj... *ndiej*), (*dhe*/për këtë arsye, për këtë shkak, për pasojë... *ndiej*); kohore (*të të mashtroj dhe / pastaj/ndërkohë... të të puth...*), përcaktuese (*dhe*/në këtë rast... *s’do dimë...*), etj., duke nxjerrë edhe më në pah modalitetin e dyshimit e dëshirës.

Rrjeti izotopik në poezi nuk shfaqet vetëm në raport me përpunimet dhe përzgjedhjet leksikore e semantike, por edhe ato fonetike e prozodike; për shembull, tempo-ritmika në treshe dhe theksimi në fund, i fjalës së fundit të vargut. Rendi numërues në treshe krijon një sfond ritmik që përveç disiplinimit dhe qëndrueshmërisë tempo-ritmike të thënieve, bart si element të mbishtresuar edhe qëndrueshmërinë e nënvetëdijshe që është ngulitur tashmë si përvojë intelektuale, por gjithësi edhe religjioze (nga ngulitja e formulës së trinisë së shenjtë). Në çdo rast, rindërtimi dhe rikuptimësi është bashkëshoqërues në këtë kontakt me këto njësi tekstore.

Efektet e përfuara nga mjetet fonetike a prozodike përforcohen kur kombinohen edhe me procedë të tjera të natyrës gramatikore. Shembull domethënës është në këtë rast vargu: *...mos duhet vall prapë të të mbart...*, që i rreshtuar pas vargjesh që shenjojnë përkujdesje, për nga mënyra e strukturimit të tij ngjall njëherazi ndjesinë e plogështisë dhe lodhjes, ngadalësimit të veprimit të përfuatur nga tepria e pjesëzave të përdorura në mënyrë të njëpasnjëshme, që shenjojnë modalitete (mohim + mundësi + dyshim + rimarrje/ përsëritje) që brenda asaj hapësire të vogël paradigmatiche vonojnë shprehjen e predikativitetit në ngjizjen e fjalisë; për pasojë, ndjesia e plogështisë, por edhe e kohës më të shumtë për meditim që do të vijojë, e mban pezull këtë pritshmëri (largësia mes foljes modale *duhet* dhe lidhore të *mbart* është e pazakontë për shqipen).

Situata e të thënit a skenografia, si bartëse të polifonisë dhe shumëkuptimësisë

Fokusimi në rrjetin metaforik të pranishëm në thurimë, dhe evokimet që përlindin natyrshëm në raportet e krijuara në paraqitjet mendore të cilat barten përmes përzgjedhjeve leksikore të bëra nga poeti, na çojnë në përfytyrimin e një skene të thëni ku janë të pranishme dhe veprojnë njëherësh *qeniet diskursive*

që i japin ekzistencë vetë mesazhit. Skena e të thënit ose skenografia, sipas emërimit të Maingueneau-së, është formësuar me praninë e folësit, tek i cili gjëlljnë dy qenie diskursive (njëra që pohon dhe shqetësohet, dyshon, rreket e kërkon), dhe tjetra që mohon. Këto dy pikëshikime mundësojnë në tekst praninë e një thëniepërfutuesi/enonciateur që nuk shprehet, megjithëse ka të pranishme gjurmët e tij aty dhe ndikon në këtë mënyrë në kuptimësimin e tekstit; është ky thëniepërfutues i dytë që përfaqëson *qenien zbuluese* në kuptimin heidegerian, që ka një qasje ekzistenciale ndaj botës, ndaj realitetit, ndaj dashurisë, ndaj së dashurës. Pikërisht kjo qasje ekzistenciale parakupton dhe motivon dy gjetjet që përbëjnë tharmin e poezisë, *kristalizimin* dhe *polenizimin*, si forma të ruajtjes dhe konservimit, madje të ripërtëritjes, si teknikë elitare në diskursin letrar, e në veçanti atë surrealit. Duke u shprehur përmes mohimit, pra duke parakuptuar në ligjërim edhe një thënës të dytë brenda vetes, marrëdhënia ligjërimore e përfuatur motivon dyshimin, pasigurinë, dëshirën, kureshtinë, angazhimin, indiferencën..., më së paku, qasjen ekzistenciale ndaj botës dhe dashurisë.

Në pamje të parë, pikëvështrimi lokalizohet në brendësi për të vënë në dukje statusin e marrëdhënies ndjesore, të karakterizuar nga krijimi i distancës me të



dashurën nga mpakja deri në fikje e gjurmëve të ndjenjës; më tej, si realitet i brendshëm, bëhet i vëzhgueshëm përmes interpretimit të imazheve të përfuara nga perceptimet e objekteve të vëzhgueshme; ky status i marrëdhënies nistore në ligjërim krijon mundësi për vijim të poetizimit të situatës dhe përfutimit të marrëdhënieve të tjera me objektin e poetizimit – ndjenjën e dashurisë – që vëzhgohet tashmë së jashtmi, e sendëzuar, e trupëzuar, e vëzhgueshme, e manipulueshme, e aftë si e tillë t’u nënshtrohet lojërave ligjërimore; e për pasojë, të ngjizet përmes metaforizimeve a proceseve metonimike, të vihet e lihet e përjetësuar në poezi, në muzikë, të varroset, të gdhendet në mermer, madje të sublimohet në morg-kristal a përjetësohet duke u ripërtërirë në vijimësi, si poleni që ruan e riprodhon llojin. Ndjesia e harrimit transpozohet në objekte të vëzhgueshme që bartin dhe parakuptojnë ruajtjen, konservimin, madje ripërtëritjen e llojit a gjësendit. Është në këtë rast pragu i kalimit që i jep paraqitjes, *mimesis*-it poetik, premisat për ekzistencë spekulative.

Statusi i tekstit dhe jehona e ndërtekstorësisë

Qenia njerëzore është gjithnjë në kërkim e shqyrtim, e gjithnjë e palumtur në këtë proces, sepse vetë procesi

nuk është i fundëm, çka përbën edhe premisën e kësaj “palumturie”; por në një kuptim më të gjerë, përbën pikërisht premisën e kuptimit të vetë qenies; e në terma pozitivë, edhe të vetë lumturisë. Toposi i dashurisë është ndër më të përshtatshmit për t’u ngjizur ky status. Mëdyshja në këtë qasje, poetizimi i saj, metaforizimi i marrëdhënieve, përvijimi i analogjive nga më të larmishmet kanë përfuatur qysh në fillesat e ligjërit poetik modele që përbëjnë kulme në letërsinë botërore. Në trajektoret e ngjizjes së këtij toposi, përvojat analogjike me dukuritë e botës materiale që në procesin e shndërrimit të materies në vlera estetike, e madje edhe përtej tyre, përmes procesit të sublimimit e kristalizimit kanë përvijuar praktika të suksesshme dhe domethënëse. Rasti i Stendalit (sajues i termit të *kristalizimit* në trajtimin e këtij toposi) ka shënuar një praktikë të marrë e rimarrë më tej edhe nga psikanaliza, e veçanërisht nga surrealiteti. Për këta të fundit, kristali, motiv gjithnjë i pranishëm në trajtesat e tyre, “duket se kondenson një ideal estetik: transparencën, imazhin e njohurisë absolute”. Feks në trajtesat e surrealitëve me motiv kristalin (të përfuatur prej kristalizimit), kujtimi i analizave stendaliane (Trouvé, 2003:14-15). Për A. Bretonin, kristali paraqet idealin e së bukurës: “Vepra e artit, thekson ai, ashtu si çdo copëz e jetës njerëzore, e vështruar në domethënie e saj më të thekshme, më paraqitet e zhvlerësuar nëse nuk paraqet ashpërsinë, ngurtësinë, rregullsinë, shkëlqimin e kristalit në të gjitha faqet e tij së brendshmi dhe së jashtmi”. (Breton 1937:681). Pranëvënia e kristalit me koralet, e minerales me organiken, e admirimit për atë përsosmëri formash e shkëlqimi me realitetet njerëzore, janë shprehje e qasjes ndaj atij ideali estetik, ku njerëzorja, organikja e inorganikja ruajnë dhe bartin vlera deri në transcendencë.

Këto flukse ndriçimi që duket se ngjizin sërish shndërrime të toposit të dashurisë drejt rivlerësimesh dhe analogjish, ku sërish ngjizet një ideal estetik, duket se joshin muzat e poetëve; Kadareja është treguar vijimisht i vëmendshëm ndaj kahjes që ato joshin dhe ka guxuar; poezia “Kristal” është sërish një shembull.

Poetët, në kohë e vende të ndryshme, mund të pikëtakohen natyrshëm në ato hapësira letrare, duke sjellë përvoja dhe teknika vetjake, që veçse e popullojnë më dendur atë mjedis. Përkimet me përvojat, teknikat a konceptet e pranishme në përvoja të ndryshme letrare, sidomos në ato me të cilat operon rëndom poezia surrealiste, veçse ia përforcojnë më shumë statusin këtij teksti, drejt përcaktimit të vendit atje. Është një kontekst vlerash në të cilin arritën ta bëjnë të pranishme qenien e tyre atje edhe poetët e vendeve ku imponohej doktrina zyrtare e realizmit socialist, çka vërehet edhe te poetët dhe artistët në Hungari, Çekosllavaki, Serbi a Ruman të atyre viteve. Gjithësi, motivimet në çastin e krijimit, të përfuara në studion e poetit mbeten të fshehta, e shkrimtari i ruan për vete dhe i merr me vete ato. Teksti, megjithatë, bën jetën e tij dhe na jep nxitjet për t’u përqendruar edhe në mjediset prej të cilave ai merr ndriçime. Sa më qartë t’i dekurtojnë ato flukse drite, aq më të plota i receptojmë edhe ato profile; e për pasojë, aq më i plotë është edhe rindërtimi nga ana jonë i kuptimit të tekstit dhe aq më funksional bëhet rikontekstualizimi i tij. Kompensojmë, në një farë mënyre, edhe pengun e të pathënave, që po ashtu janë të ndryra në atë proces krijues.

Në mbyllje... në një jubilar

Shkrimtari ka përparësinë të na lërë përmes fjalëve, shenjat që na joshin në vijimësi t’i interpretojmë, brendi të tyre që në vijimësi na nxisin t’i rikontekstualizojmë, e në këtë mënyrë t’i ri-ndëtojmë, duke qenë vetë të pranishëm në ato realitete të përfuara; gjithësi, jubilarët e shkrimtarëve, edhe ky jubilar i Kadaresë, mund të na sugjerojnë sërish se sa i pamoshë është poeti, ose se sa i ri është ai brenda përmasave të moshës së Poetëve. Variantet e të lexuarit e të interpretuarit, qoftë edhe të një poezie të vetme, na ofrojnë edhe neve si lexues një rishfaqje tonën në kontekste që po ashtu na nxisin të jemi *qenie zbuluese* dhe, për këtë arsye, edhe më dinjitozë në realitetet jetësore të përditshmërisë, duke bartur, si pa dashje, atë çka tekstit ia blatuam së jashtmi e, në këtë mënyrë, edhe vetvetes.

(Botohet me shkurtime)

Kongresi i Lushnjës, i 100 vjetëve më parë, që nisi punimet në 21 janar 1920 dhe vazhdoi deri në 31 janar të atij viti, është quajtur dhe si “pavarësia e dytë e Shqipërisë”, sepse e shpëtoi vendin jo vetëm nga një copëtim i ri, por dhe nga zhbërja.
Për këtë kongres unikël në historinë e kombit, ka dhe një dramë, të vetme, e shkruar nga Hekuran Zhiti, e pa vënë ndonjëhere në skenë, por që u zbulua dhe botua nga “Uegen” me rastin e 100-vjetorit.
Po sjellim për lexuesin tonë pjesë nga akti final i dramës së Hekuran Zhitit, nga pasthënia e botimit e historianit dhe shkrimtarit Xhevair Lleshi si dhe fjalën përmbyllëse nga Visar Zhiti, biri i autorit të dramës.

ZËRAT E HISTORISË NË DRAMËN E VETME TË KONGRESIT TË LUSHNJËS

- ME RASTIN E 100 VJETORIT -

HEKURAN ZHITI -nga Akti III i dramës “Të mblidhemi në Lushnjë”

Në Kongres:

Salla me 10 ose 12 sërë karrigesh. Në krye një tryezë e madhe, në anë të saj një flamur kombëtar me shtizë dhe një portret i Skënderbeut në njërën dhe i Ismail Qemalit në anën tjetër. Kongresistët, disa me veshje karakteristike të Veriut e të Jugut dhe disa me kostume evropiane, borsalina e gravata e çanta, janë shpërnarë në grupe, dy e nga tre, duke biseduar...

Lushnjarë e bashkë me ta e të tjerë të armatosur, Vathi, Bajrami, Vrenozi, Thimi u etj., si roje rrinë pak larg, hyjnë dhe dalin.

ZËRA:

- ...kam ardh mes borës, ujque dhe ushtrisë serbe...
- E madhe shtëpia... e mblodhi Shqipërinë...
- ...nuk kanë mbrritë të gjithë...
- ...ku ishit mbrëmë?
- Këtu afër. Na kanë pritur me këngë. Këndonin me radhë dhe dilnin bënin roje me pushkë jashtë shtëpisë...
- ...kush e kishte Korçën, grekërit apo francezët?
- Francezët për grekërit...
- Shiko Plakun e Butkës... legjendarin...
- ... sa kohë që s’jemi parë? Qysh në Vlorë,
- ...atë ditë kur u ngrit flamuri...
- A fillojmë, burra? Koha nuk pret...
- I përndershmi Sheh Karbunara do t’i bëjë një lutje Zotit, që të na bekojë... ogur i mirë... në mbrojtje nga të papriturat e shumta... ka kaq trazira...

(Të gjithë pa lëvizur nga vendi ngrijnë në heshtje dhe secili, sipas mënyrës së vet, luten, dikush me kokën lart, me duart e bashkuara, me kryet ulur, ndonjë gjunjëzohet, mermërisin etj., në mes tyre Sheh Karbunara i statujtë duke krijuar kështu një si grup skulpturor sugjestionues, suprem...)

- Përfaqësuesi i Lushnjës ta marrë fjalën... Zoti Vokopola nise...

PËRFAQËSUESI I LUSHNJËS: Në emër të Prefekturës së Lushnjës, Beratit e Skraparit ju uroj mirëseardhjen në Kongres. Nuk jemi këtu vetëm në shtëpinë e mikut tonë bujar, lushnjarit të nderuar Kaso Fuga, por dhe brenda mureve të historisë. Po nisim një betejë, sot më 21 Janar 1920, e mërkurë, që nuk do të harrohet, e ndjeje... *(emocionohet)* Zini vendet... në këtë sallë... por dhe në ngjarjet që na presin...

Ia jap fjalën patriotit të flaktë, veprimtarit të palodhur kundër pushtimit otoman, mbështetësi kryesor i Ismail Qemalit, ministër në qeverinë e parë, Elbasan Pashës, i zbardhur në përpjekjet për çështjet e më mëmëdheut. Urdhëroni!

ELBASAN PASHA *(I moshuar, me pak mjekër të bardhë, i hollë, i thatë, me kravatë e qylaf, me zë të ngadaltë e pak të ngjirur):* Të dashur qytetarë, delegatë nga i gjithë vendi, ju që keni ardhur dhe ata që nuk kanë arritur ende, por dhe ata që nuk do të vijnë dot kurrë se janë vrarë për ideal, (duartrokitje të forta), luftëtarë, burra që më bëtë nderin ta çel këtë kuvend, vazhdim i atij të Lezhës me Skënderbeun dhe i atij të Prizrenit me Abdyl Frashërin me shokë, duke ju falenderuar me shpirt, shpall të hapura punimet. Së bashku të hapim udhën që do të ndjekim. Nëpër vazhden e gjakut do të shkojmë ku na e do zemra e plasur që të

arrijmë te ëndrra, atje ku na e do puna, sipas amanetit të të parave. Shqipëria është bërë një herë dhe nuk ka pse zhbëhet! *(Duartrokitje)*

Zotërinj, jeni të lodhur, e di, keni ardhur rrugë e pa rrugë, mes përmes pushtonjësve të Shqipërisë, kjo na ka vrarë më shumë se sa të tatëpjetat, shtigjet e humnerat, se nata me erë e bora, kemi ecur me mjete që prisheshin, kështu e lanë atdheun tonë, me karroca e kuaj e më këmbë, po u shplohëm që gjetmë sho-shoqin e do të bëhemi me flatra kur të gjejmë dritën që na duhet.

Kam kërkesën që të nderojmë dëshmorin e kësaj ideje, bashkëpunëtorin tonë të ngushtë, Abdyl Ypin, që e vranë ca ditë më parë për të mos qenë këtu ai dhe të gjithë ne e ky Kongres të mos mbahej. Nëpërmjet tij duam të përulemi para gjithë të rënëve dhe martirëve të Kombit...

Të gjithë ngrihen më këmbë. Heshtje e thellë...

KRYETARI *(i porsazgjedhur)* Të vazhdojmë më tej... të formojmë komisionet, që tani, të ndahen përfaqësonjësit në grupe dhe... Po emërojmë Sekretarin e Kuvendit, zotin Vokopola dhe për të këqyrur letërpërfaqësimet e delegatëve, pra një komision të posaçëm prej 5 vetash... Hë, të presim... për të mos pritur...

DELEGATI I MATIT *(ngrihet)* Unë jam për sulm, i përndershmi Sheh!

ZËRA: Me shka, me çfarë?

DELEGATI I MATIT: Me armën e diplomacisë, me diplomacinë e armëve.

DELEGATI IV: burra, gra, djem e pleq, me spata e me hunj, me armët që kemi, të përzëmë armiqtë nga toka jonë. Të hedhim si leckë qeverinë e sotme, që nuk bën për sot. *(Duartrokitje)*



KRYETARI: Traktatin e Fshehtë të Londrës... Kongresi e hedh poshtë me vendosmëri duke përgatitur një protestë energjike për Konferencën e Parisit.

Kjo bëhet në emër të Asamblesë së Kombit në Lushnjë, kundër vendimeve të Francës, Anglisë, Italisë për copëtimin e Shqipërisë ndërmjet Italisë, Greqisë, Sërbisë e Malit të Zi. Rezolutën, na vjen një kërkesë, përfundoje kështu *(lexon)*: Shqiptarët janë gati të bëjnë çdo lloj sakrifice dhe me e derdh pikën e fundit të gjakut të tyre kundër çdo veprimi, që mundet me vue në rrezik pamvarësinë dhe tërësinë e saj tokësore...

Ndizen drita ngadalë, salla e kuvendit, përfaqëuesit nëpër vende, kongresi vazhdon punën...

SHEH KARBUNARA: Të tregojmë që dimë të qeverisim. Shteti i pavarur shqiptar është realitet. Kështu kanë bërë dhe disa shtete të tjera të robëruara, zotërinj, kështu Çekosllovakia, Finlanda, Polonia, Lituania... Edhe ne. Shtet i vjetër, qeveri e re!

ROJET E ARMATOSURA: Rroftë Qeveria e re!... *(Duartrokitje)*

NËNKRYETARI: Të përgatiten tekstet që do t'i dorëzohen Konferencës së Paqes në Paris dhe Senatit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sugjerime!

PLAKU I BUTKËS: T'i drejtohem Parlamentit italian, por jo me ton të butë, kështu m'u duk se dëgjova, me lal e me lule ose me tryla si thotë myzeqari. Me spatët dardharit siç e përdorin nga Korça...

PËRFAQËSUESI I MATIT: Shkronjat duhet të bjenë erë barut!....

VRENOZI: Zoti ka urdhëruar këtë Kongres për të shpëtuar Shqipërinë.

DELEGATI IV: Populli është mbret vetë dhe s'ka nevojë për mbretër, sulltanë e perandorë.

KRYETARI: Të gjykojmë situatën ku ndodhemi.

DELEGATI II: Kongresi do përballet dhe do krijojë situatë vetë. Ne na shkon republika, republika, zotërinj dhe asgjë tjetër.

ZËRA: Republikë, po, po republikë...

THOMAJ: Mbështetur nga shumë pëlqime, mendoj të kemi kryeministër zotin Sulejman Delvina.

DELEGATI I: Tani ai ndodhet jashtë shtetit, në Konferencën e Parisit, pra askush këtu nuk mendoj tjetrin pranë a vetveten.

DELEGATI II: Gjithmonë më i mirë është ai që mungon... *(Të geshura)*

KRYETARI: S'është ashtu gjithmonë. Ne i dimë vlerat e mëdha të zotit Delvina, rrjedh nga një familje ndër më të njohura dhe më të famshme në të gjithë Jugun. Ka kryer gjimnazin e Janinës dhe mandej në Stamboll. Fakultetin e Mylqijes në kryeqendrën e Perandorisë Osmane dhe pas marrjes së diplomës, siç e dini, ai u caktua menjëherë atasheut në Ministrinë e Brendshme të Turqisë dhe më pas si sekretar në zyrën e dekreteve të Kryeministrit. Po në ato vite, ai shërbeu si profesor i literaturës në Gallata Saraj, etj. Në Bibliotekë gjithmonë e gjeje me libra francezë, të kulturës dhe shkencës perëndimore, dihen dhe interesi i tij e adhurimi dhe mirënjohja për Amerikën...

DELEGATI II: Ai të vijë sa më shpejt. Ministër i Punëve të Mbrendshme Delegatin e Matit, Zogun e maleve, trimin 25 vjeçar... po, po... Ministër i Punëve të Jashtme z. Mehmet Bej Konica... Ministër i Arsimit z. Sotir Peci... Ministër i Drejtësisë z. Hoxhë Kadri Prizrenin... Zëvendës z. Hysen Bej Virjoni... Ministër Finance Z. Ndoc Çoba... Zëvendës z. Idhomen Kosturi... *(Votohen. Duartrokitje...)*

KRYETARI: Tani nuk na mbetet gjë tjetër, veç të bëjë betimin Këshilli i Naltë dhe Qeveria e re dhe të gjithë delegatët për ato që marrim përsipër. *(Heq flamurin me shtizë e del para tavolinës duke e mbajtur në dorë.)* Urdhëroni, zotërinj, të bëjmë betimin më të lartë para Kombit.

(Delegatët ngrihen në këmbë ndërsa të zgjedhurit afrohen para Flamurit.)

SEKRETARI *(Lexon me zë të lartë):* «Beto hem n'Emën të Perëndis, tue dhanë besën shqiptare e fjalën e nderit përpara Mbledhjes së Kombit, se do t'i shërbej popullit dhe shtetit shqiptar drejtësisht dhe mproj ligjet dhe indipendencën e plotë të atdheut të shenjtë!»

TË ZGJEDHURIT *(Një zëri)* Beto hemi!

(Duartrokitje. Kryetari u jep dorën. Delegatët ulen.)

NJË ZË: Dua të shtoj dhe poetin e madh Gjergj Fishta! Le ta kenë si sekretar më vonë...

NJË ZË TJETËR: Rroftë Poeti! *(Duartrokitje prapë.)*

KRYETARI: Kongresi i Lushnjës është Pavarsia e Dytë e Atdheut!

SEKRETARI: Si kujtim nga ky Kongres kemi ca flamurë të vegjël si lulkuqet e fushave me grurë të Muzeqesë, vërin nga ana e zëmrës. Këta do t'i shpërndajmë kudo.

Shpërndan flamujt e vegjël.

NJËRI NGA DELEGATËT: Ja, kështu dua ta kem plagën në gjoks në luftë për atdhe...

ZËRA TË ASHPËR: Jeni të rrethuar... ndalni!... Kongres i paligjshëm... Dorëzohuni... do ju shpërndajmë me forcë...

(Jehona e kërcënimeve përsëritet në gjubë të tjera, italisht, greqisht, serbisht: ndalni... të rrethuar...)

MINISTRI BREND SHËM SHQIPTAR: Largohuni! Kongresi shqiptar është mbledhur si vullnet i popullit dhe jo në mëshirë të ndokujt, ushtri qoftë a qeveri e huaj. Po ju them që mos u përzieni në punët tona, përndryshe do ju godasim. Ne nuk duam armiq, por bëni mirë të largoheni nga Lushnja... dhe nga Shqipëria. Ndryshe do ju përzëmë dhe me luftë. Unë, bashkë me forcat e mia të armatosura do të marrshojmë drejt Tiranës!

NJË ZË I ASHPËR: Kush jeni ju?

MINISTRI I BREND SHËM: Ministri i Brendshëm i Qeverisë së vendit tim. Hapnu udhën!

ZËRI: Mos lëvizni.

MINISTRI I BREND SHËM: Unë nuk njoh tjetër autoritet, përveç Kongresit të Lushnjës. Ju përdorni armët që keni në dorë, në guxofshi. *(Të vetëve.)* Përpara me mua! *Hingëllima kuajsh, trokëllima...*

Bie perdja.

XHEVAIR LLESHI Trinia: kongresi, drama autori

1- Pa Kongresin e Lushnjës do të humbte si në shkretëtirë Pavarësia e Shqipërisë, e arritur nëntë vjet para Ngjarjes së Madhe. Pa Kongresin e Lushnjës Pavarësia do të kish mbetur nën rrebeshet e tmerrshme të kohërave që, siç kishin kaluar nëpër Luftën e Parë Botërore, priteshin të binin sërish mbi trupin e Atdheut... Por Kongresi erdhi. E sollën ata, atdhetarët e fisëm e të mëdhenj të Shqipërisë, që, të tillë kanë mbetur për jetë.

Kanë 100 vjet që ata i kemi në bronz dhe ky jubile na i sjell sërish afër, duke pasur ndjesinë sikur ka ndodhur dje....

Lexoja shënimin e Visar Zhitit bash për këtë ditë të shënuar e për dramën e saj dhe m'u duk se ishim në të njëjtin përdytyrim. «*Përfaqësues, të përzgjedhur apo të vetëaktuar, nga të gjitha trevat e vendit, kush e ndjente dhe mundte, nga ata që kishin bërë emër, kryengritës a nëpunës, që kishin qenë në Vlorë 8 mote më parë në ngritjen e Flamurit të Pavarësisë, që kishin punuar në perandorinë otomane apo kishin studiuar nëpër Evropë, që kishin mërguar deri në Amerikë, nga ata që kishin bërë për vendin dhe kishin sakrifikuar, u nisën për në Lushnjë, me ndonjë makinë, nga ato të pakat që ishin atëherë, e ngadaltë si gerret, me kuaj, në këmbë, kaptonin male, çanin borën dhe baltën e dimrit, rreziqet nëpër shtigjet ku mund të gjendeshe befaz mes ushtrive të huaja...*»

Çfarë sakrifice dhe vetëdijësimi!...

“Të mblihdemi në Lushnjë!” ishte thirrja. Pa telegraf, por me thirrjen e thjeshtë të zemrës, se vetëm ashtu do të shkruhej ndryshe historia, pa menduar ndonjë tender se ku mund të mblihdeshin dhe s'i mund të ndaheshin milionat, sepse ishte rreziku i ndarjes së atdheut.

...Dhjetë ditët e Kongresit të Lushnjës! Në to do të ribëhej shteti shqiptar, do të caktohej kryeqyteti, Tirana (me të sotmen e papërfytyrueshme atëherë!), «do të emërohej kryeministri dhe qeveria e tij për t'i dalë zot vendit, institucionet dhe detyrat.»

...Pushka e gjatë e Sulës Zdravës, me të cilën kishte marrë pjesë në Rrethimin e Shkodrës apo kishte mbrojtur Beratin nga andartët grekë, çante qiellin dhe errësirën, ngrohte shpirtin dhe jepte forcë... fare i vetëm do të bënte epokë...

2- Në moshën 60 vjeçare, dramaturgu Hekuran Zhiti përfundon dramën e tij të fundit për një nga dramat më heroike të atdheut, Kongresin e Lushnjës.

E shkruante për Lushnjën, për mundësitë e saj të pakta atëhere, në një fletore të zakonshme, me atë shkrimin e bukur, pak të pjerrët e të shpejtë si rilandasit, duke besuar, sado pak se do të mund të vihej në skenën e tetatrit pranë sarajeve ku mbajt vetë kongresi apo aty te shkallët.

Është një dramë popullore, me atë gjuhë e me personazhë të tillë, jo nga ata që bëjnë historinë, por nga ata që e pësojnë atë, siç na thotë Visari dhe atë po vazhdoj të citoj, - ku ndihen shqetësimet, intrigat e kohës, vuajtja, lufta, përpjekjet ekzistenciale të njeriut dhe vendit dhe befaz akti final, i treti, Kongresi shpëtimtar, ai që realizoi



pavarësinë e dytë të Shqipërisë.

Hekuran Zhiti na duket se e shkruante këtë dramë si një testament të atyre burrave që i dolën zot vendin në një kohë tejet të vështirë dhe pastaj ikën një nga një e u futën në histori.

Hekuran Zhiti po i thërriste. Ndoshta ky ishte dhe testamenti i tij. Që do ta përfundonte i biri, Visar Zhiti, që na e solli të plotë dramën. Dhe ky është libri i tretë i autorit tonë...

3- «Hekurani, pasi mbaron shkollën fillore në Berat, shkon për studime në “Normalen” e famshme të Elbasanit, ku spikat për vjershat e tij satirike dhe interpretimet në skenë, i vlerësuar nga pedagogët e tij si Simon Shuteriqi, babai i shkrimtarit dhe studiuesit Dhimitër Shuteriqit, dhe Karl Ljarja, babai i aktorit Rikard Ljarja etj., por edhe nga shokët e klasës si shkrimtari i ardhshëm Sterjo Spasse etj. Ëndrra e tij u bë teatri. Luante në pjesët teatrale që përkthenin pedagogët dhe nisi të shkruajë edhe vetë.»

Revista *Normalisti* (botuar në Tiranë, shtypshkronja *Shkodra*, 1933) ka edhe këtë kujtim të bashkëstudentit të tij, Vasil Vaska: «...Gjith natën e kaluem tue bamë gas, tue këndue e tue çfaqun një komedi të trillueme prej H. Zhitit...» Kurse miku tjetër i klasës, Haki Ballshi, në një kumesë do të thoshte:

«E qeshura, sipas Hygoit të madh, është dielli që përzë dimrin nga fytyrat e njerëzve. Dhe neve na e hiqte dimrin nga fytyrat e qeshura që na jepte një diell-njeri, një humorist i rrallë, shoku ynë i klasës H. Zhiti. Ai ishte Omar Khajami ynë... Portretin e tij nëpër reklama e shëtisnin hamejtë e skenës rrugëve të qyteteve, duke u bërë kështu humoristi më i mirë i Jugut...»

«Ne e kishim idhull H. Zhitin», - do të thoshte në Uashington, në «Zërin e Amerikës» gazetari i mërguar Ilia Therecka, ish-i burgosur politik...»

«*Normalistët* bëjnë një turne në të gjitha qytetet kryesore të Shqipërisë, se kur e njih vendin, e do edhe më shumë. Në Shkodër i prit patriarku i letrave shqipe, Atë Gjergj Fishta, që e vlerësoi Hekuranin sipas dëshmime gojore...»

...Krijimtaria e Hekuran Zhitit ka tërhequr vëmendjen e lexuesit dhe të kritikës, e cila ka bërë ta rikujtojë jo vetëm në dheun amë, dhe në Kosovë e Maqedoni, por dhe më gjerë, tek arbëreshët në Itali, në diasporë e deri në SHBA.

Së pari, doli postume përmbledhja me poezi «Kryengritje shqiptare në parajsë», ku qëmtohet kryesisht krijimtaria e Hekuran Zhitit e shkruar gjatë Luftës së Dytë Botërore, para dhe pas saj, si dhe një pjesë nga satirat,

ku në mënyrë parodike përmblihdet se kërkon të këndoje «trimëritë e një Ak(c)ili».

Më pas dolën njëherësh «Shtatë komedi». Po i rendisim titujt: *Nusja në thes, Palla e nderit, Shakaxhinj dhe bataqçinj, Magjistari i rremë, Gratë e atij fshati, Rruga e Skraparit, Të përmbysurit.*»

Në ballinat e librave janë dy vizatime të nipit të autorit, Atjonit fëmijë, që i bëri posaçërisht për veprën e gjyshit.

«Hekuran Zhiti – shpirti krijues që priti kaq gjatë», do të shkruante prof. dr. Josif Papagjoni (“Mehr licht”, Tiranë, 2007. Dhe më pas e përmbledhur në enciklopedinë Teatri & Kinematografia Shqiptare, Tiranë, 2009).»

Papagjoni thekson: «...jo shpesh ngjet që të zbulohet krejt një autor i panjohur më parë nga lexuesi i gjerë; një autor i ngujuar diku në pjesën e territ të kohës a të fatit... Një zbulim... çka është një ringjallje e shpirtit të një autori që lipset të zërë vendin e vet të merituar në banesën e hirshme të dramës e të teatrit, një ringjallje... ky autor elegant, aq shpotitës, modelimi i një moleriani shqiptar, a Kalderoni, a Goldoni, plot shije e nur?...»

«...nuk mund të rrimë pa shfaqur habinë dhe admirimin tonë të singertë. Në çast më vijnë në mendje autorë të tillë, si Kristo Floqi me komeditë e tij të shkurtra apo Et'hem Haxhiademi me tragjeditë e tij. Janë bashkëkohës në letërsi, dy të parët tashmë të mirënjohur dhe me vendin e tyre të nderit në historinë e dramaturgjisë shqipe, kurse Hekuran Zhiti krejt i panjohur, pa një vend meritore dhe detyrimisht me nxitimin për t'i dhënë kurorën e mohuar që i takon...»

Kritiku tjetër Mexhit Prençi thekson: «*Vizioni i qartë i autorit e ka orientuar që ta kërkojë të qeshurën komike, jo te hunda e shtrembët, as te gunga e kurrizos, as duke u tallur me dialektet e gjubës shqipe, apo përqeshur personalitetet e ndritura historike të kombit (siç ndodh sot në më shumë se një ekran televiziv), por te morali i deformuar i njeriut dhe shpirti i shëmtuar i tij.*» ...

Sot një rrugë në qytetin e Lushnjës mban emrin “Hekuran Zhiti” dhe ai është shpallur dhe “Qytetar Nderi”.

VISAR ZHITI Në ndjekje të porosisë

...si e pa përfunduar, e mbetur në dorëshkrim që nga mesi i shekullit të kaluar, - kisha thënë, - por me gjakimin, që, nëse do t'ia kërkonin ndonjëherë të vihej në skenë, autori do ta rimernte dhe do ta përshtaste me kohën, domethënë me rrethanat, jo veç ato të skenës, të vegimit regjisorial dhe lojës së aktorëve etj, ngaqë Kongresi i Lushnjës, i quajtur dhe si Pavarësia e Dytë e Shqipërisë, është një ngjarje kulmore në histori, e patundshshme, që kërkon përtëritje në riparje, në shëmbëlltëyrën e lartë që dha, të përbashkimit dhe të mënçurisë, të veprimeve të guximshme në shpëtimin e vendit.

Nuk e di a kishte menduar autori rënien e perandorisë komuniste dhe të diktaturave të saj. Ai besonte e jetonte dhe me Shqipërinë e vjetër, atë të përjetshmen. Kështu e pa dhe Kongresin e Lushnjës, një dramë me tre akte, nga e zakonshmja tek ato që ikën me përditshmërinë, nga antropologjia në rreziqet ekzistenciale e deri tek derdhja si në bronz e një altoreliefi të ngjarjes së madhe.

Në ndjekje të asaj porosisë të heshtur, tani me rastin e 100 vjetorit të Kongresit të Lushnjës, botuesi UEGEN ndjeu detyrën e ribotimit të dramës, ashtu të plotësuar dhe të përfunduar, me atë dëshirë siç e nxori në dritë për herë të parë në vitin 2011, në 100 vjetorin e lindjes së autorit dhe në prag të 100 vjetorit të Pavarësisë së vendit, por tani dhe me pasionin e historianit dhe të shkrimtarit, kështu që z. Xhevair Leshi vendosi t'i shtonte botimit të ri pak histori për Kongresin dhe autorin, për t'u kuptuar, më saktë për t'u ndjerë më mirë drama e Kongresit dhe e autorit, që edhe pse ngjajnë të largëta midis tyre dhe nesh, kanë lidhje dhe kanë prodhuar njëra-tjetrën ndërsjelltas.

Gjithmonë ka një prag jete dhe vdekjeje. Pragu i vdekjes është dhe në jetë, ndërkohë që dhe pragu i jetës është edhe në vdekje. Ka dhe ringjallje...

Kongresi që u mbajt në Lushnjë, sërish i duhet vendit, jo vetëm si kujtesë kolektive, aq më tepër tani që ka dy shtete shqiptare në Ballkan dhe zjen ankthi i bashkimit, me rreziqet e zhbërjes ndryshe, me modernitetin globalizues. Se duhet t'i bashkohemi së tërës (BE) me identitetin tonë, që kohërat e deshën të jetë sakrificë e heroizëm, por dhe një mrekulli.

LEXIMI NË EPOKËN E SHPËRQENDRIMIT TË PARESHTUR

Mairead Small Staid



“Lexoj libra për të lexuar veten”, shkroi Sven Birkerts në “Elegji për Gutenbergun: fati i leximit në një epokë elektronike”. Libri i tij, i cili sivjet mbush njëzet e pesë vjet që është botuar, përbëhet nga pesëmbëdhjetë ese për leximin, veten, pikëtakimin e tyre, dhe mënyrat se si të dyja kërcënohen nga depërtimi i teknologjisë moderne. Ndërsa kultura rreth tij pësoi ndryshimin e sakjshëm që solli interneti, Birkerts-i pati frikë se cilësitë e mbrojtura dhe të vlerësuara për një kohë të gjatë të librit të shtypur kishte rrezik që dalëngadalë të zhdukeshin: ndër to, privatësia, vlerësimi i vetëdijes individuale dhe vetëdija për historinë, jo thjesht për faktet e saj, por ndjenjën e vazhdimësisë së vendit tonë gjatë shekujve dhe në kozmos. “Letërsia ka kuptim jo si përmbajtje që mund të shkëputet dhe përmbledhet, por si përvojë”, shkroi ai. “Ajo është arenë pjesëmarrëse. Përmes procesit të leximit, ne shmangim orientimin e zakonshëm në lidhje me kohën, i cili karakterizohet nga shpërqendrimi dhe sipërfaqësorja, për të dalë në mbretërinë e të përhershmes”.

Duke shkruar në 1994, Birkerts-i ishte i shqetësuar që shpërqendrimi dhe sipërfaqësorja do të fitonin. “Gjendja e të përhershmes” që përjetojmë në një faqeje libri do të humbas në një botë ku shpejtësia dhe fjet ndërlidhëse të saj rriten në mënyrë të pamëshirshme, dhe me bashkë me do të humbas edhe aftësia jonë për t’u dhënë kuptim rrëfimeve, si atyre të trilluara ashtu edhe atyre jetësore. Rrudhja e letërsisë, e leximit të përhershëm, e shkrimit si produkt i një mendjeje të vetme të përqendruar, do ta rrudhte ne, duke na bërë gjithnjë e më pak të aftë të rrokim gjerësinë e botës dhe po kështu thellësinë e vetëdijes tonë individuale. Për Birkerts-in, ashtu si për shumë lexues, të menduarit e një humbje të tillë është rrënues. Ndërsa munda ta përfytyronte këtë të ardhme të errët, të afërt, ai (më së shumti) i rezistoi shtysës mazokiste për ta parashikuar më konkretisht se duhet, duke u përqëndruar tek e tashmja, ku, për një kohë më gjatë, ai të paktën lexon, dhe shkruan. Përmbledhja e tij me ese për leximin, pavarësisht nga titulli, nuk ngjan edhe aq me elegji për letërsinë se sa me një përpjekje për ta ndaluar vdekjen e saj duke shkruar në mënyrë bindëse për jetën e tij kushtuar leximit dhe qëndresën ndaj ndikimit shpërqendruar të elektronikës. Birkerts-i na kujton se një jetë e tillë ka vlerë, ke dëshirë ta jetosh dhe çfarë është më e rëndësishmja, është akoma e mundur. Përballë asaj që po humbasim, ai dëshmon për atë që akoma mund të fitojmë.

Një çerek shekulli më vonë, a arriti ai, a arritëm ne të shpëtonim çfarë mund të shpëtohej? Apo frika më e madhe që kishte Birkerts-i është tejkaluar? Është e vështirë të thuash nëse shohim numrat. Numri i librarive të pavarura që po hapen është më i madh se i atyre që mbyllen, dhe shitjet e librave të shtypur janë në rritje, por fitimet e autorëve janë në rënie. Më pak amerikanë se dikur lexojnë për kënaqësi.

Një shtëpie e madhe botuese u mbyll kohët e fundit, ndërsa aplikacioni me rrëfime të instaluara “Wattpad” njoftoi obekktivin për të botuar libra të zgjedhur nga algoritmet, pa pasur nevojë për redaktor. Disa nga ndryshimet që Birkerts-i pa të shfaqeshin në horizont – shpikja e librave elektronik dhe mundësitë e hipertekstit dolën të jenë më pak të rëndësishme se sa ishte parashikuar, por ndryshimet e tjera janë më të këqija si për shembull, shpërqendrimi tejet i shpeshtë dhe varësia nga ekrani që gllabëron orët tona.

Ndoshta rreziku më i madh për letërsinë s’është asnjë nga këto shpikjet e reja teknologjike apo përditësimet e tyre të zhurmshme, por thjesht lakmia e lashtë njerëzore në versionin e saj më të fundit dhe më të madh që një shitës librash me pakicë në internet shfaqti në të njëjtin vit që u botua “Elegji për Gutenbergun”. Gjatë njëzet e pesë vjetet e fundit, Amazon ka treguar babëzi për gjërat e lehta dhe që kushtojnë lirë, këto vlera të kapitalizmit, duke kërcënuar se do të monopolizoj jo vetëm botën e librave, por edhe botën në tërësi. Përballë një kërcënimi kaq tinzar, gllabërues – jo thjesht ky gjigand i teknologjisë, por kultura që ai krijon dhe mbështet ma bën të vështirë ta shkëpus frikën për të ardhmen e librave nga frika për të ardhmen e ekonomive të qytezave, për demokracinë amerikane, për tokën dhe ngritjen e nivelit të detrave.

“Dhjetë, pesëmbëdhjetë vjet më pas, bota s’do të jetë fare siç e mbajmë mend, asgjë s’do të jetë si tani”, shkroi Birkerts-i. “Do të notojmë në impulse dhe të dhëna, mikroçipi do të na bëjë oferta që do të jenë shumë të vështira për t’u refuzuar”. Në të vërtetë, pak


prej nesh nuk i kanë pranuar. Ndërsa çdo teknologji e re, që nga smartfon-at deri tek pajisjet ndihmëse shtëpiake që aktivizohen me zë, bëhet pjesë normale e jetës së përfutshme, shumë shpejt, aftësia jonë për ta refuzuar zvogëlohet. Zgjedhja e paraqitur në “Elegji për Gutenbergun”, midis pranimit dhe skepticizmit, vështirë se duket më si një zgjedhje: brezi i ri tani lind i mbështjellë me krahët e shumtë të botës digjitale.

Unë jam dhe nuk jam pjesë e këtij brezi të ri. U linda në 1988, dy vjet para zhvillimit të sistemit të strukturimit dhe formatimit të dokumenteve në internet. Nuk kam pasur kompjuter në shtëpi deri në shkollën e mesme, as celular derisa mbusha tetëmbëdhjetë vjeç. Më kujtohet kur merrja në telefon me aparatura tradicionale dhe mbaja vesh për piiip-in e dhimbshëm, të mezidëgjueshëm. Facebook-u u përhap kur mbarova shkollën e mesme ndërsa Twitter-i kur hyra në kolegji. Orët e arta të fëmijërisë përputhen në mënyrë të përkryer me dritën e venitur të një bote të para-internetit. Thellë brenda meje e di që një botë e tillë ka ekzistuar dhe kishte përparësitë e saj.

Birkerts-i, duke kujtuar pushtetin që kishin librat tek ai kur ishte i ri, shkruan: “Përmes leximit dhe të jetuarit unë dalëngadalë u khteve në një provë e magjepsjes të plotë pas autorëve të librave. Sidoqoftë, kaq të gjalla janë kujtimet e mia për atë shtysë të fuqishme leximi, për atë ndjenjë përjetimi, saqë vazhdoj të kërkoj ta përjetoj edhe sot”. Gjendja shpirtërore që krijohet nga një libër, ajo gjendje në të cilën ti je “i pranishëm në mënyrë aktive në çdo çast, ndërsa lexon atë që është shkruar duke e rikrijuar gjatë leximit”, është ajo që kërkojnë lexuesit, argumenton Birkerts-i: “Ata duan subjekt dhe personazh, natyrisht, por ajo që në të vërtetë duan është një mjet që i kalon në gjendjen e leximit. Kjo gjendje kërcënohet nga interneti gjithëpërhapës. A mundet që premtimi i librit për prani të thellë të na largoj nga kënaqësia e menjëhershme e “pëlqimeve” dhe “shpërndarjeve”?

“Puna me vite në librari më ka bindur se kjo gjendje themelore krijohet edhe për të tjerët”, shkruan Birkerts-i. Kur ishte i ri, ai punoi për një librari të quajtur “Borders”, pjesë e rrjetit asokohe të pvarur të librarive “Ann Arbor”. Pas katër dekadash, tërhoqa libra nga libreria “Literati Bookstore”, në qendër të Ann Arbor-it, Miçigan, pak blloqe banesash më tutje nga ku banoja unë. Raftet e librarisë së dikurshme “Borders” ishin blerë dhe përshtatur nga pronarët në këndin e librave letrar, ndërsa klientët që i shfletonin ishin po ato, sepse librat ishin renditur si më parë dhe ishin po ato tituj, dhe u jepnin po atë ndjesi kur i merrnin në dorë për të shfletuar faqet e para.

Dhe nëse klientët donin libra të modeluar sipas internetit, libra dhuratë të rrjeteve sociale Tumblr, Instagram, ata i shtypnin dhe lidhnin. Kërkohej libri “Aguliçet” i Maggie Nelson-it, “Qyteti i hapur” i Teju Cole, “Cari i dashurisë dhe teknologjisë”, i Anthony Marra, “Mos lejo të jem i vetmuar” i Claudia



Rankine-s. Vetmia është ajo që interneti dhe rrjetet sociale mëtojnë ta luftojnë, megjithëse shpesh kanë efektin e kundërt. Lidhja shpirtërore është e vështirë për t'u krijuar, jo sepse ne s'jemi në të njëjtën hapësirë fizike por sepse s'jemi në të njëjtën rrafsh mendor: s'lexojmë të njëjtin lajm; madje as nuk argëtohem nga e njëjta meme.

Telefonat dhe kompjuterët i japin secilit prej nesh një variant të personalizuar, ose më saktë, të kryer sipas algoritmeve të titujve, anekdotave, shakave dhe fotografive. Madje edhe reklamat që na kalojnë para syve s'janë të njëjta me ato që shohin fqinjët tanë: një palë çizme më kanë dalë para sysh në faqe të ndryshme interneti për javë të tëra. Ne e quajmë këtë material të pafund, jolëndor, një ushqim, ku zor se gjen ndopak vlera ushqyese.

Argumenti i Birkerts-it (dhe i imi) nuk është se librat e luftojnë vetminë. Të mëtossh se çdo aplikacion dhe faqe internet këtë synon, do të thotë ta humbasësh luftën për letërsinë para se të filloj. Jo, fuqia e artit (dhe shumë libra vazhdojnë të jenë ende art, jo argëtim) qëndron në mënyrën se si na bën të shohim në të njëjtën kohë botën brenda dhe jashtë nesh. Lidhja shpirtërore që kërkojmë, marrja në duar e librave ose shfletimi i faqeve, s'do të thotë se jemi me të tjerët, madje as me me të gjallët e as me të vdekurit qëkuri, të cilët shkruan çfarë po lexojmë, por se jemi me veten tonë. Aftësinë tonë më të mirë, aftësinë e jashtëzakonshme që kemi për të dialoguar me veten, priremi ta harrojmë shumë shpejt.

Në fillim të “Elegji për Gutenbergun”, Birkerts-i përmbledh përkufizimin e historianit Rolf Engelsing për leximin “e thellë” si praktikë e zakonshme e shumicës së lexuesve para shekullit të nëntëmbëdhjetë, kur librat, të cilët ishin të pakët dhe të shtrenjtë, shpesh lexoheshin me zë të lartë dhe disa herë. Ndërkohë që u përhapën në mënyrë masive materialet e leximit, jo vetëm librat, por edhe gazetatat, revistat dhe biografitë, gjatë shekujve të fundit u vu re përhapja gjithashtu e leximit “të shpejtë”. I lexojmë këto materiale një herë, shpesh e shpejt, dhe kaq. Birkerts-i krijon terminologjinë e tij: praktika e thellë, e devotshme e leximit “vertikal” është zëvendësuar nga leximi “horizontal”, i cili cek sipërfaqen. Kjo zhvendosje është përsheptuar marramendshëm që nga koha kur shkroi Engelsing-u në 1974, qëkur shkroi Birkerts-i në 1994, dhe qëkur unë shkrova dhe, paragrafin më lart.

Leximi horizontal sundon gjatë gjithë ditës. Ajo që bëj kur shoh çfarë shkruhet në “Twitter” është më pak e ngjashme me leximin e një libri se sa me leximin e udhëzimeve të një recete ose me shifrat e shndritshme të një fature: më japin informacione, nuk më ndriçojnë për ndonjë gjë. Është një mënyrë për të kaluar kohën, jo për të jetuar. Leximi, leximi i vërtetë, ai lloj leximi për të cilin Birkerts-i është mbrojtës i flaktë – mbështetet tek ndjeshmëria jonë vertikale, sado e fshehtë, dhe “kur nuk gjen thellësi, e krijon atë”.

Nuk kam më adresë në Facebook, dhe shoh se po harxhoj gjithnjë e më pak kohë në internet. Ndërsa vitet më shtohen mbi supe, asnjë modë kalimtare, s'po më kthehet në gjendje kronike, përkundrazi, tërhiqem gjithnjë e më shumë nga leximi që të kërkon të përfshihesh plotësisht si ai në fëmijëri. Librat kanë ndryshuar, dhe përtvetësimi nuk është gjithmonë aq i gjithanshëm sa dikur, por mund të gjej akoma, si shënimet e lëna midis faqeve, atë që Birkerts-i e quan “koha e vetes... kohë e thellë, kohaëe gjatë, koha që në thelb na bën të përhumbemi plotësisht. “Dhurata e leximit, dhurata e çdo takimi me artin, është se kjo kohë nuk më braktis kur heq sytë nga libri që mbaj në prehër: zgjat, një minutë ose një ditë. “Diçka më shumë se një shkujdesje gjatë bisedës më lejon t'i them një shoku se jam duke lexuar “Ushtari i mirë” i Ford Madox Ford-it, kur po shëtisnim në rrugë së bashku”, shkruan Birkerts-i. “Në një farë mënyre unë *po e lexoj* romanin ndërsa ec, kur fle, kur kotem apo shkoj me makinë në dyqan për të blerë qumësht”.

Fatkeqësisht, kjo jehonë që vijon është e vërtetë



edhe për leximin horizontal. Nëse kaloj një kohë tepër të gjatë para faqeve digjitale, edhe ajo përvojë vijon në orët që pasojnë. Ekranin shfaqet para syve të mi të mbyllur; mendimet e mia përsillen rreth *përmbajtjes së ligjëratis*: ripodhimit të saktë të saj, dhe hamendësimit të pikëpamjeve të kundërta. Debate të tilla i përfytyroj edhe në dush. “Kur një vepër të detyron të bëhesh njësh me të, shpesh ka fuqinë që të ndjek pas edhe kur je larg saj”, thotë Birkerts-i, dhe sa do të dëshiroja që kjo përhumbje të ishte pushtet vetëm i një vepre të madhe. Por nuk është: fantazmat depërtojnë përmes fjalëve në ekran, fantazmat e fjalimeve dhe çmendurive, e urrejtjes dhe idiotësisë, të sa e sa shkrimeve të dobëta.

“Por mbase kur nevoja është e madhe, e kërkojmë fjalën në faqe dhe veprën që na bën të kthehemi në fushën e forcave të kohës së thellë”, thotë Birkerts-i. “Libri dhe optimizmi im, mund ta merrni me mend, nuk është i palëkundur se do të shihet si strehë, si një mënyrë për t'u shkëputur nga bota në një hapësirë të shenjtëruar nga subjektiviteti”. Është e çuditshme, që edhe në fillim të vitit 2019, optimizmi im është i fortë. Për mua është e qartë se nevoja është mjaft e madhe, po aq e fortë sa ka qenë dhe do të jetë gjithnjë e më e madhe nevoja për kënaqësinë fizike të leximit të diçkaje të mrekullueshme, në një mënyrë që më rrëmben aty për aty duke më treguar në pëllëmbë të dorës atë që më largohej gjatë gjithë kohës.

“Pa jehonën e asaj që lexon, nuk ka dituri”, shkruan Birkerts. “Jehona është një dukuri e natyrshme, hija e domethënies së bashku me trupin e faktit, dhe s'mund të lulëzoj përveçse në kohë të thellë”. Por koha duket

veçanërisht e cekët këto ditë, ndërsa vala e një tmerri rrallë kthehet në dallgë sepse gllabërohet nga një tjetër, ndërkohë që një titull tronditës lajmi në mëngjes vjetërohet deri pasdite. Javët kalojnë, dhe miqtë mund t'i shohim vetëm përmes pasqyrave të shtëpisë argëtuese të “Snapchat-it” dhe Instagram-it dhe të ashtuquajturave “tregime” të tyre, të projektuara për t'u zhdukur. Bashkë me të zhduket edhe ideja e të përhershmes: freskojmë dhe rifreskojmë çdo skedë dhe nuk i ke më. Çfarë presim atëherë? Çfarë shpresojmë të gjejmë?

E dimë shumë mirë, e mbajmë mend, edhe nëse në mënyrë të vagullt, atë gjendje të brendshme gjatë leximit që të kënaq më shumë se të shtypësh derisa të lodhesh me gishta në tastierë, kur dihet se ajo që lexojmë në ekran, në një kuptim s'është aty. Sepse, *aty* në internet, ka një hapësirë të askundit, një kohë të cekët. Sipërfaqja e internetit është e sheshtë dhe e padepërtueshme. Por kur lexon një libër, ne zhytemi, fundosemi, shkrihem me leximin në trup e shpirt. “Mbajmë në duar një mënyrë për ta zvogëluar vrullin e kohërave”, na siguron Birkerts-i. “Mund t'i bëjmë qëndresë prirjes për sipërfaqësoren dhe të rrëmojmë nëpër libra sepse kështu mund të rimarim, qoftë edhe për pak kohë, përgjegjësinë që shmangim rrokjen e së të tërës. Bukuria e përfshirjes në lexime vertikale qëndron tek mungesa e nevojës për të dëshmuar dobinë e vet. Thjesht procesi të përmbush si i tillë”.

The Paris Review
Përktheu: Granit Zela

SHËTITJE NË



HËNË ME



AJNSHTAJNIN



Arti dhe shkenca e të mbajturit mend gjithçka

JOSHUA FOER



Minerva